



Gjeneralmajor Manushaqe Shehu: EOD, aset dhe kapacitet operacional me vlera të veçanta për FARSH

Në mjediset e batalionit të Xhenios të Komandës Mbështetëse, u zhvillua ceremonia e nisjes së Kontingjentit XIII EOD, i cili do të marrë pjesë në misionin e Prezencës së Përparuar të Përforsuar (Enhanced Forward Presence - eFP) të NATO-s, si pjesë e grup-batalionit kanadez të dislokuar në Letoni.

Në ceremoninë e organizuar me këtë rast mori pjesë zëvendëshefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH-së, gjeneralmajor Manushaqe

Shehu, komandanti i Komandës Mbështetëse, gjeneral brigade Ferdinand Dimo, drejtorë drejtorish të Shtabit të Përgjithshëm, familjarë, etj. Në përshëndetjen e saj drejtuar trupave, gjeneralmajor Shehu u shpreh ndër të tjera: "Struktura EOD është bërë një aset dhe kapacitet operacional i sprovuar në shumë angazhime brenda dhe jashtë vendit me vlera të veçanta për Forcat e Armatosura dhe Shqipërinë, e cila është e

aftë të kryejë detyra shumë të vështira. Kam bindjen që personeli i këtij kontingjenti do të jetë në lartësinë e detyrës së ngarkuar dhe do të mbajë lart e me krenari flamurin tonë kombëtar në Letoni...".

Ceremonia vijoi me dorëzimin e flamurit për Kontingjentin XIII EOD, nga komandanti i Komandës Mbështetëse, gjeneral brigade Ferdinand Dimo dhe u përmbyll me një foto të përbashkët.

» faqe 4



Ministri Peleshi: Së bashku me aleatët jemi të vendosur në mbështetje të paqes dhe sigurisë në rajon



» faqe 3

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi pret Kreun e Zyrës së Gardës Kombëtare të Shteteve të Bashkuara

Anija P - 132 "Oriku" merr pjesë në Stërvitjen Ndërkombëtare "ADRION CAX - LIVEX 2023"

Përgatitja e oficerit shqiptar, liderit me karakter

Ministri i Mbrojtjes, z. Niko Peleshi dhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm, gjeneral brigade Arben Kingji pritën në një takim Kreun e Zyrës së Gardës Kombëtare të SHBA-së, gjeneral Daniel R. Hokanson. Gjatë takimit u diskutua mbi mjedisin aktual të sigurisë dhe sfidat në kufirin lindor të Aleancës, situata në rajon dhe ajo në Ukrainë, siguria kibernetike, angazhimet e vendit tonë në kuadër të NATO-s si dhe me fokus të veçantë bashkëpunimin në fushën e mbrojtjes me SHBA-të. Nga të dyja palët u shpreh shqetësimi...



» Faqe 2

Në Bazën Detare Pashaliman u realizua ceremonia e përcjelljes së anijes P - 132 "Oriku", e cila do të marrë pjesë në Stërvitjen Ndërkombëtare "ADRION CAX - LIVEX 2023", (Live Exercise - Computer Assisted Exercise), me destinacion në Itali. Në ceremoni mori pjesë komandanti i Forcës Detare, kundëradmiral Adnand Agastra, i cili mbasi u njoh nga komandanti i Flotiljes Detare Pashaliman, kapiten i rangut I Engjëll Sinanaj, me përgatitjen e efektivave dhe marrjen e masave për pjesëmarrjen e anijes në këtë stërvitje, falënderoi efektivat dhe i uroi suksese...



» Faqe 3

Ndryshimet rrënjësore në mjedisin strategjik të sigurisë, padyshim që diktojnë zhvillimin e forcës, reformimin dhe modernizimin e tyre, nivelin e gatishmërisë, aftësisë për të qenë ndërveprues, të qëndrueshëm dhe efikas në operacionet me vete apo me aleatët, si dhe doemos kërkojnë një trupë ushtarake profesionale dhe të mirë trajnuar. Këto ndryshime përherë dhe më shumë diktojnë nevojën e evoluimit dhe zhvillimit të procesit të arsimit, trajnimit dhe stërvitjes për përgatitjen e personelit të Forcave të Armatosura, për një spektër...



» Faqe 10-11

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi pret Kreun e Zyrës së Gardës Kombëtare të Shteteve të Bashkuara

Ministri i Mbrojtjes, z. Niko Peleshi dhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm, gjeneral brigade Arben Kingji pritën në një takim Kreun e Zyrës së Gardës Kombëtare të SHBA-së, gjeneral Daniel R. Hokanson.

Gjatë takimit u diskutua mbi mje-disin aktual të sigurisë dhe sfidat në kufirin lindor të Aleancës, situata në rajon dhe ajo në Ukrainë, siguria kibernetike, angazhimet e vendit tonë në kuadër të NATO-s si dhe me fokus të veçantë bashkëpunimin në fushën e mbrojtjes me SHBA-të.

Nga të dyja palët u shpreh shqetësi-mi për konfliktin në Ukrainë, ndërsa u theksua rëndësia e vijimit të mbështetjes nga aleatët. Vëmendje të veçantë mori edhe situata aktuale në veriun e Kosovës, si dhe ndikimi i mundshëm në stabilitetin e rajonit të Ballkanit Perëndimor. Ministri Peleshi theksoi rëndësinë e prezencës së trupave të NATO-s në lindje, Letoni dhe Bullgari, dhe njëkohësisht në KFOR, Kosovë.

Ministri i Mbrojtjes theksoi gjatë bisedës rolin dhe angazhimet e vendit tonë për garantimin e paqes dhe sigurisë në rajon e më gjerë. Ai u ndal në sfidat për zhvillimin e kapaciteteve të Forcave



të Armatosura të Shqipërisë në përballje me situatën aktuale të sigurisë.

Ministri Peleshi vlerësoi rolin e Zyrës së Gardës Kombëtare të SHBA-së. Ai shprehu njëherësh mirënjohjen për mbështetjen e vazhdueshme dhe të pakushtëzuar që SHBA ka dhënë për vendin tonë, duke nxjerrë në dukje në mënyrë të veçantë bashkëpunimin e shkëlqyer në fushën e mbrojtjes me Gardën

Kombëtare të New Jersey-it dhe mbështetjen e dhënë prej tyre për zhvillimin e kapaciteteve të FARSH.

Gjenerali Hokanson shprehu mirënjohjen e tij për rolin e Shqipërisë në NATO, duke e vlerësuar Shqipërinë si një vend partner dhe aleat tepër i besueshëm. Gjenerali Hokanson deklaroi se mbështetja e SHBA-ve do të jetë e vazhdueshme për përmirësimin e kapaciteteve në përballje me sfidat e kohës.



Forca Ajrore vijon modernizimin e flotës ajrore

Forca Ajrore, në bashkëpunim me "US Army Security Assistance Command" (USA SAC) dhe me Zyrën e Bashkëpunimit Usharak të SHBA-së (ODC), zhvilloi aktivitetin "Rishikimi i Menaxhimit të programit #2" (Program Management Review #2), në lidhje me vlerësimin dhe rishikimin e programit për modernizimin e flotës ajrore me helikopterë tip UH - 60A.

Në takimin midis palëve u

diskutua për projektin e helikopterëve UH-60 "Black Hawk", ku Komandanti Forcës Ajrore, gjeneral brigade Ylli Pulaj mbajti fjalën e hapjes, ku adresoi çështjet që do të diskutoheshin me ekipin amerikan që menaxhon këtë projekt.

Në këtë takim u diskutuan progresi i bërë deri më tani si dhe modalitetet e fundit para mbërritjes së mjeteve ajrore, në mënyrë që Forca Ajrore të vendosë helikopterët tip UH - 60 "Black Hawk" në opera-

cionalitet dhe në gatishmëri të plotë luftarake.

Gjatë këtij aktiviteti u arrit koordinimi dhe adresimi i çështjeve për pritjen e helikopterëve UH - 60 nga pala shqiptare, mbështetjen logjistike, pjesët e këmbimit për mirëmbajtjen e këtyre mjeteve sipas konceptit "Paketë Mbështetëse Totale" (Total Support Approach Package), si dhe, trajnimin operacional për efektivin pilot dhe teknik të Forcës Ajrore.



Forca Ajrore trajnon pilotët e Njesisë së Aviacionit të Forcës së Sigurisë së Kosovës



Në Bazën Ajrore Farkë, dy pilotët të Forcës së Sigurisë së Kosovës, zhvilluan një program teorik dhe praktikë fluturuese me helikopterin AB-206. Qëllimi i aktivitetit ishte aftësimi teorik dhe zhvillimi i fluturimeve me helikopter AB-206, për ruajtjen e aftësive fluturuese të pilotëve të Njesisë së Aviacionit të Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe rritjen e operacionalitetit të tyre.

Ministri i Mbrojtjes, Niko Peleshi mori pjesë në takimin e Grupit të Kontaktit të Mbrojtjes për Ukrainën. Grupi i Kontaktit të Mbrojtjes për Ukrainën (UDCG), është një iniciativë e Sekretarit të Mbrojtjes së SHBA-ve, që mbledh së bashku aleatë dhe partnerë nga e gjithë bota, për të diskutuar mbi bashkëpunimin dhe sfidat e sigurisë që duhen përballuar si pasojë e agresionit rus në Ukrainë.

Ministri Peleshi gjithmonë ka shprehur mbështetjen e tij dhe të qeverisë shqiptare ndaj popullit ukrainas.

Edhe në këtë takim ai do të mbante qëndrimin e tij ndaj agresionit rus në Ukrainë: “Sërish së bashku me aleatët tanë, në Grupin e Kontaktit të Mbrojtjes për Ukrainën, nën drejtimin e Sekretarit të Mbrojtjes Lloyd J. Austin III, për të rikonfirmuar mbështetjen diplomatike, politike, ushtarake, ekonomike dhe sociale për Ukrainën. Të vendosur në mbështetje të paqes dhe sigurisë në rajon e më gjerë”, - tha Peleshi.



Ministri Peleshi: Së bashku me aleatët jemi të vendosur në mbështetje të paqes dhe sigurisë në rajon



Anija P - 132 “Oriku” merr pjesë në Stërvitjen Ndërkombëtare “ADRION CAX - LIVEX 2023”

Në Bazën Detare Pashaliman u realizua ceremonia e përcjelljes së anijes P - 132 “Oriku”, e cila do të marrë pjesë në Stërvitjen Ndërkombëtare “ADRION CAX - LIVEX 2023”, (Live Exercise - Computer Assisted Exercise), me destinacion në Itali.

Në ceremoni mori pjesë komandanti i Forcës Detare, kundëradmiral Adnand Agastra, i cili mbasi u njoh nga komandanti i Flotiljes Detare Pashaliman, kapiten i rangut I Engjëll Sinanaj, me përgatitjen e efektivave dhe marrjen e masave për pjesëmarrjen e anijes në këtë stërvitje, falënderoi efektivat dhe i uroi suksese në realizimin e detyrës.

Stërvitja “ADRION CAX - LIVEX 2023” është një stërvitje që zhvillohet në kuadër të nismës ADRION (Adriatic Ionian Initiative), me pjesëmarrjen e forcave detare të vendeve anëtare të cilat janë: Shqipëria, Kroacia, Greqia, Italia, Mali i Zi dhe Sllovenia.

Qëllimi i stërvitjes është përmirësimi i ndërveprimit të marinave ADRION, në kryerjen e operacioneve detare si: operacionet e ndalimit detar, kërkim - shpëtim, manovrimi detar, komunikimi si



dhe trajnimin e procedurave në planifikimin dhe zbatimin e operacioneve shumëkombëshe për të forcuar sigurinë e përgjithshme në det. Një pikë tjetër e rëndë-

sishme e stërvitjes është trajnimi i ekuipazheve në përdorimin e procedurave standarde të funksionimit sipas manualeve të NATO-s.

Kursi i Përgatitjes së Oficerit (KPO) zhvillon stërvitjen verore “Enkelejte-23”

Në Bazën Detare të Pashalimanit u organizua stërvitja verore “Enkelejte-23”. Kursi i Përgatitjes së Oficerit përgatit specialistë të fushave të ndryshme për specialitete të veçantë dhe kursantët që ndjekin këtë kurs kanë përfunduar shkollën në degë të ndryshme, në institucione të arsimit të Lartë në vend dhe jo vetëm. Qëllimi i stërvitjes verore ishte organizimi dhe zhvillimi i jetës dhe veprimtarisë në kushte fushore, në temperatura të larta dhe sa më të përafërta me ato të kryerjes së një detyre luftarake



apo misioni. Për zhvillimin e stërvitjes verore u parashikuan tema të ndryshme taktike, të cilat detyruan kursantët të planëzojnë, përgatiten dhe ekzekutojnë, duke menduar në mënyrë kritike, në varësi të situatave të krijuara nga pedagogët.



Gjeneralmajor Manushaqe Shehu: EOD, aset dhe kapacitet operacional me vlera të veçanta për FARSH

Në mjediset e batalionit të Xhenios të Komandës Mbështetëse, u zhvillua ceremonia e nisjes së Kontingjentit XIII EOD, i cili do të marrë pjesë në misionin e Prezencës së Përparuar të Përforsuar (Enhanced Forward Presence - eFP) të NATO-s, si pjesë e grup-batalionit kanadez të dislokuar në Letoni.

Në ceremoninë e organizuar me këtë rast mori pjesë zëvendëshefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH-së, gjeneralmajor Manushaqe Shehu, komandanti i Komandës Mbështetëse, gjeneral brigade Ferdinand Dimo, drejtorë drejtorish të Shtabit të Përgjithshëm, familjarë, etj. Në përshëndetjen e saj drejtuar trupave, gjeneralmajore Shehu u shpreh ndër të tjera: “Struktura EOD është bërë një aset dhe kapacitet opera-



cional i sprovuar në shumë angazhime brenda dhe jashtë vendit me vlera të veçanta për Forcat e Armatosura dhe Shqipërinë, e cila është e aftë të kryejë detyra shumë të vështira. Kam bindjen që personeli i këtij kontingjenti do të jetë në lartësinë e detyrës së ngarkuar dhe

do të mbajë lart e me krenari flamurin tonë kombëtar në Letoni...”. Ceremonia vijoi me dorëzimin e flamurit për Kontingjentin XIII EOD, nga komandanti i Komandës Mbështetëse, gjeneral brigade Ferdinand Dimo dhe u përmbyll me një foto të përbashkët.



Përfundon me sukses stërvitja kompaktësuese “HAJMELI - 23”

Në rajonin stërvitor të Vaut të Dejës, Shkodër, ka përfunduar me sukses stërvitja kompaktësuese e koduar “HAJMELI - 23”.

Kjo stërvitje e rëndësishme pati si qëllim përmirësimin e aftësive taktike në operacionet mbrojtëse, ku përgjatë 72 orëve, efektivet e Batalionit I të Këmbëorisë kombinuan taktikat e luftimit mbrojtës, me ato të dhënies së ndihmës së parë dhe tërheqjes së të dëmtuarve nga fusha e luftimit.

Kjo stërvitje, ashtu si të tjera të kryera së fundmi, tregoi edhe njëherë se strukturat e FARSH-së kanë kapacitetet e duhura operationale për të ndërvepruar në çdo lloj skenari dhe angazhimi të mundshëm.



Toga e Tretë e Kompanisë së Parë Operacionale në Policinë Ushtarake përfundon stërvitjen ndërkombëtare “Saber Guardian - 23”, në Rumani

Toga e Policisë Ushtarake ishte e integruar në Kompaninë Shumëkombëshe “508-th MP COY”, e dislokuar në Slobozia, Rumani.

Disa nga detyrat e efektivit të Policisë Ushtarake ishin ndërveprimi me trupat e tjerë ndërkombëtarë gjatë operacionit; parandalimi i akteve sabotuese, apo atyre kriminale në prapavijë; ngritja e pikave të kontrollit në interes të operacioneve të lëvizshmërisë; shoqërimi i MPW/C (të burgosurve të luftës dhe civilëve) si dhe lëvizja në zonën e operacionit nëpërmjet komunikimit të sigurt, duke treguar një nivel të lartë të përgatitjes përkrah ushtarakëve të NATO-s si pjesë të stërvitjes “Defender Europe - 23”.



KKSHP viziton Komandën e Ndërhyrjes së Shpejtë të NATO-s, Selanik, Greqi

Kursi i Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm pranë Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë, zhvilloi vizitë mësimore në Komandën e Ndërhyrjes së Shpejtë të NATO-s (NRDC-Greece) Selanik, Greqi.

Pjesëmarrësit në KKSHP u pritën

nga shefi i Shtabit të Komandës së NATO-s, i cili me anë të prezantimeve i njohu me misionin, strukturën, detyrat, si dhe me procesin e planifikimit dhe zhvillimit të operacioneve. Pjesë e programit akademik ishte dhe vizita në Muzeun e Luftës së Greqisë.



Efektivët e BMEC të KM, kontribuojnë në nismën e pastrimit për mjedise të pastra në bashkinë Shkodër

Forcat dhe mjetet e Bazës së Mbështetjes të Emergjencave Civile (BMEC) të Komandës Mbështetëse, u nisën në drejtim të Shkodrës, duke iu bashkëngjitur nismës së bashkisë për pastrimin e ambienteve në zonat turistike të Velipojës dhe Shirokës.

Puna e trupave tona në këtë operacion konsiston në grumbullim e transportim mbetjesh e inertesh të ndryshme. Gjatë fillimit të operacionit ishin të pranishëm komandanti i Komandës Mbështetëse, gjeneral brigade Ferdinand Dimo, kryetari i bashkisë Shkodër Benet Beci, ministrja e Turizmit znj. Mirela Kumbaro, ministrja e Shtetit znj. Elisa Spiropali, të cilët vlerësuan këtë nismë dhe përgëzuan trupat tona në kryerjen e kësaj detyre.

Në këtë operacion, trupave tona iu

bashkëngjitën shumë vullnetarë, të cilët dhanë ndihmesën e tyre në mbledhjen dhe grumbullimin e mbetjeve në zonën e Velipojës. Gjatë dy ditëve janë kryer pastrimi i një sipërfaqeje prej 2100 m², si dhe rreth 57 m³ transportim mbetjesh e inertesh për në landfillin e Bushatit.

Operacioni do të vijojë deri në pastrimin e tërë zonës së Velipojës e Shirokës.



24 vite nën qiellin e lirë të Kosovës martire

Kosova shënon 24-vjetorin e çlirimit apo një nga ditët më të rëndësishme të historisë së vendit. 24 vjet më parë në Kosovë u vendosën 50 mijë ushtarë të NATO-s.

Më 12 qershor 1999, pas 78 ditë bombardimesh të Aleancës Ushtarake Perëndimore të udhëhequr nga Amerika, kundër caqeve ushtarake serbo-malazeze në Kosovë në Serbi dhe Mal të Zi, trupat e NATO-s hynë në Kosovë me misionin paqeruajtës KFOR, duke i dhënë fund luftës gati dyvjeçare midis popullsisë kryengritëse shqiptare të organizuar në radhët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe forcave okupuese ushtarake dhe policore serbo-malazeze.

Ushtarët e parë të NATO-s që hynë në Kosovë, më 12 qershor, ishin forcat speciale të Norvegjisë dhe ato të Shërbimit Special Ajror Britanik.

Hyrja e ushtarëve të NATO-s hapi rrugën e kthimit në shtëpitë, tokën dhe vendin e tyre mbi një milionë shqiptarëve të Kosovës të larguar refugjatë në dhjetëra vende dhe tre-katër kontinente të botës.

Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK), dhe lufta çlirimtare e saj ishin shumë të rëndësishme për lirinë e vendit.

12 qershori i vitit 1999 është ditë e shenjtë për shqiptarët - Çlirimi i Kosovës

Një ëndërr patriotike, që nga Rilindja Kombëtare e deri në vitin 1999.

Shqiptarët kishin një ditë të shenjtë, 28 Nëntorin e vitit 1912, Pavarësinë e Shqipërisë. Por tani kanë dy ditë çlirimi, dy shtete dhe një popull.

Një histori e dhimbshme kjo, por heroike. Por edhe një flamur, ky është flamuri i Gjergj Kastriotit me shqipen dykrerëshe.

Flamur i shenjtë për shqiptarët që, pasi kishte dridhur turqit, u futi dridhmat edhe serbëve edhe grekëve, sepse edhe shqiptarët e Kosovës luftërat e tyre heroike për bashkim kombëtar dhe pavarësi, me flamurin e Gjergj Kastriotit i kanë bërë.

Kjo datë e rëndësishme për popullin Kosovar, agimin e saj e nisi para të rënëve të atdheut dhe varrezat e Jasharëve, një fis i tërë i shuar për të gëzuar ditën e lirisë. E para e vendit, presidentja e Republikës së Kosovës znj. Vjosa Osmani është shprehur përherë mirënjohëse për gjithë vizionarët e shtetit, aktivistët, ushtarët e UÇK-së dhe për aleatët që ndihmuan në çlirimin dhe pavarësinë e vendit.

“Sot shënojmë përvjetorin e një prej ditëve më të rëndësishme



në historinë e kombit tonë, në historinë e Republikës së Kosovës, ditën kur shteti ynë u çlirua pas një lufte, e cila rezultoi me gjenocid ndaj një populli të pafajshëm. Tani po nderojmë ushtarët e NATO-s, ata që nga 10 qershori e tutje hynë në Republikën e Kosovës për t'ia dhënë vulën e çlirimit të vendit tonë”. Kush përjeton një luftë, atij i ndryshon përgjithmonë jeta.

24 vjet kanë kaluar nga lufta e Kosovës, por pasojat ende janë prezente. Në jetët e njerëzve, dhimbjen që la ajo për familjarët, por edhe shkatërrimin e kudogjendur. Ende ka shumë pyetje të hapura për kohën e luftës në Kosovë. Rreth 13 500 njerëz u vranë gjatë luftës së fundit në Kosovë (1999). Këto të dhëna jepen nga institucione të ndryshme në Kosovë, por, më së miri janë të evidentuara nga organizata Fondi për të Drejtën Humanitare, të prezantuara në Librin e Kujtimit të Kosovës (LKK) mbi të gjitha viktimat e luftës në Kosovë nga të gjitha etnitë. Sipas kësaj organizate gjatë luftës në Kosovë janë vrarë ose janë zhdukur gjithsej 13 535 njerëz. Kjo shifër është nxjerrë në bazë të analizës së 31 600 dokumenteve nga burime të ndryshme, në mesin e tyre edhe nga një numër i madh i deklaratave të viktimave dhe të dëshmitarëve të krimeve të luftës. Në numrin e të vrarëve, shqiptarët e Kosovës përbëjnë numrin më të madh të viktimave, me 10 812, serbët 2 197, kurse romët, boshnjakët, malazezët dhe joshqiptarët e tjerë përbëjnë



526 viktima gjithsej. Në hulumtimin e FDH-së, nxirren statistika edhe në bazë të komunave më të mëdha, ku del se territori i Gjakovës në përfundim të Kosovës, ka pasur humbjet më të mëdha. Në Gjakovë kanë mbetur të vrarë 1 022 civilë shqiptarë. Pas Gjakovës renditet Skënderaj me 984 të vrarë, Glllogovci me 804 vetë, Rahoveci me 724, Peja me 561, Prishtina me 466, Prizreni me 464, Vushtrria me 451, Suhareka me 434, Mitrovica me 417 vetë.

Për sa i përket vrasjes së civilëve serbë në krye ndodhet Komuna e Prishtinës, ku të vrarë kanë mbetur 130 civilë serbë, më pas vjen Gjilani me 98 serbë të vrarë, Prizreni me 80, Peja me 79, Rahoveci me 71, Gjakova me 61, Klina me 56, Lipjani me 43, Suhareka me 40 dhe Istogu me 39 civilë serbë të vrarë. Me gjithë këtë numër të evidentuar të personave të vrarë nga forcat serbe të sigurisë, edhe sot 24 vjet nga përfundimi i luftës së Kosovës, 1 647 persona konsiderohen si të pagjetur dhe për ta ende nuk dihet asgjë.

Dëbimi i shqiptarëve të Kosovës nga forcat serbe gjatë luftës Gjatë periudhës së luftës së Kosovës, mbi 800 mijë shqiptarë të Kosovës u dëbuan nga shtëpitë e tyre nga forcat serbe të sigurisë. Këto të dhëna gjenden në një raport të organizatës së OKB-së për refugjatët, (UNHCR), e cila njofton se 862 979 refugjatë u larguan nga Kosova nga 23 marsi deri më 9 qershor 1999. Një shifër e ngjashme përmendet edhe në një raport të OSBE-së, ku thuhet se 863 000 civilë u dëbuan nga Kosova mes marsit dhe qershorit të vitit 1999. Ndërkohë, “Amnesty International” thekson se “deri në fund të luftës në Kosovë në qershor të vitit 1999, më shumë se gjysma e popullatës civile të Kosovës jetonin në kampe refugjatësh në Shqipëri dhe Maqedoni”.

Të pagjeturit pas luftës

Prej përfundimit të luftës e deri më sot, në Komitetin Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq dhe Komisionin Qeveritar të Kosovës për Persona të Zhdukur, sipas kërkesave të familjarëve, janë evidentuar 6 057 raste të personave të zhdukur, si pasojë e luftës në Kosovë. Fati i shumicës prej tyre tashmë është zbardhur, por për 1 647 persona ende nuk dihet

asgjë. Autoritetet e Kosovës, por dhe organizatat joqeveritare ndërkombëtare bëjnë të ditur se rreth 80% e personave të zhdukur gjatë luftës kanë qenë meshkuj të moshës prej 18 deri në 40 vjeç. Pjesa tjetër janë e moshës 41 deri në 60 vjeç, por ka pasur raste të rrëmbimeve dhe zhdukjeve të personave mbi moshën 60-vjeçare.

Varrezat masive pas luftës

Në Kosovë e në Serbi pas përfundimit të luftës u zbuluan një sërë varrezash masive. Në dokumentet e Tribunalit të Hagës, në aktakuzat e prezantuara për shumë të akuzuar për krime lufte nga pala serbe, prej marsit të vitit 2000 janë identifikuar 529 varreza masive, shumica dërmuese e tyre në Kosovë. Në këto varreza janë gjetur trupat e pajetë të 4 300 personave të vrarë.

Pas kaq shumë vitesh është shumë e vështirë të gjenden burimet primare, për shkak të vdekjes ndërkohë të shumë dëshmitarëve dhe mungesës së dokumentacionit. Mirëpo në këtë proces mund të ndihmojë bashkëpunimi i institucioneve të Kosovës dhe Serbisë, si edhe burimet e Tribunalit të Hagës, të cilat kanë evidentuar dhe krijuar një arkiv për shumë krime.

Historia nuk duhet harruar, për të kuptuar që e tashmja jonë për të gëzuar hisen e diellit që na takon ka ardhur mes dhimbjesh të jetëve të humbura të njerëzve të pafajshëm, të atyre që dolën për të mbrojtur atdheun e tyre prej shkjaus serb.

Gëzuar pra festën e Çlirimit të Shtetit Shqiptar të Kosovës!



Politikat e arsimit në gjuhë të huaja dhe sfidat për realizimin e tyre në FA

INTERVISTOI: MIMOZA GOLIKJA

Departamenti i Gjuhëve të Huaja në Fakultetin e Mbrojtjes dhe Sigurisë në AFA, është departament i rëndësishëm që synon aftësimin e personelit të FA-së, për t'iu përgjigjur kërkesave të integritetit dhe bashkëpunimit me strukturat euro-atlantike dhe vendet e tjera partnere. Ai përgatit plane e programe mësimore dhe realizon mësimdhënien e gjuhës angleze për AFA-në dhe kurset e veçanta që hapen me personelin ushtarak e civil të FA-së, duke synuar arritjen e niveleve sa më të larta sipas standardeve të NATO-s. Mbikëqyr dhe realizon kurset e gjuhës gjermane, frënge e të gjuhëve të vendeve fqinjë si gjuhë të dyta ose fakultative të planifikuara dhe përgjigjet për përkthimin dhe përshtatjen e literaturës së huaj për nevojat e FA-së, sipas planeve të miratuara. Departamenti kryen testime për të përzgjedhur kontingjentet që do të studiojnë në shtete të ndryshme të botës dhe që marrin pjesë në misionet ushtarake të Aleancës. Planifikon dhe zhvillon punën shkencore në drejtim të përsosjes së programeve, metodave dhe teknikave në drejtim të mësimin, testimit dhe përkthimit të gjuhëve të huaja në funksion të objektivave të FA-së. Për të mësuar më shumë po sjellim intervistën që i morëm për shtypin ushtarak, drejtorit/shef i qendrës/departamentit të Gjuhëve të Huaja z. Bledar Vrapi.

Z. Bledar Vrapi, mirë se erdhët në faqet e shtypit ushtarak! Ju jeni drejtues i departamentit të Gjuhëve të Huaja në Fakultetin e Mbrojtjes dhe Sigurisë, AFA, por njëkohësisht jeni i njohur si për ushtarakët ashtu edhe për civilët e FA-së, pasi puna juaj, tashmë prej më se 26 vjetësh, është tepër e lidhur me ta. Si u gjendët brenda FA-së?

Rrugëtimi im në Forcat e Armatosura është i gjatë, kam filluar punë në gusht të vitit 1996 në miniqendrën e atëhershme në SHQUP. Më vonë ndodhi riorganizimi dhe vendosja e kësaj miniqendre në KDS në vitin 2000 dhe ne u zhvendosëm këtu. Karriera ime, mund të them se ka qenë graduale, nga pedagog deri në vitin 2004, shef i Seksionit të Testimit deri në vitin 2007, shef i Departamentit të Testimit dhe Përkthimit deri në vitin 2018 dhe drejtor/shef i qendrës/departamentit të Gjuhëve të Huaja, aktualisht. Një përvojë e gjatë brenda jetës ushtarake të FA-së, si personel civil, por edhe një rrugëtim i bukur me sfidat e punës që gjithashtu më ka dhënë shumë satsfaksion.

Veprimtaria e Departamentit tuaj si vazhdim i Qendrës të Gjuhëve të Huaja të FA-së, shënon mbi 20 vjet që nga dita e rrugëtimit të saj më 1996, por me një status të qartë, theksuar në urdhrin e MM të vitit 2003, që bazohej mbi ligjin e arsimit të lartë të atëhershëm në vendin tonë. Tashmë e gjithë kjo përvojë e grumbulluar dhe punë e kryer nga ju si një pjesë e rëndësishme e FA-së e gjen veten brenda një organizimi të ri, siç është AFA. Çfarë ka ndryshuar dhe çfarë do të thotë ky ndryshim për ju?

Në vitin 2000 u bë riorganizim dhe ne, “miniqendra” jonë e Gjuhëve të Huaja u bë pjesë e KDS-së, vendosur në garnizonin e sotëm “Skënderbej”. Për arsye të ndryshme ligjore dhe përputhje me arsimin e lartë në RSH, varësia ka ndryshuar disa herë si KDS, Universiteti Ushtarak “Skënderbej”, Akademia e Mbrojtjes, Akademia e Forcave të Armatosura dhe së fundmi autoriteti ynë është AFA, Fakulteti i Mbrojtjes dhe Sigurisë.

Por ajo çfarë nuk ka ndryshuar është misioni dhe detyrat kryesore, të cilat mbeten të njëjta për ne, arsimimi dhe testimi në gjuhë të huaj i personelit ushtarak dhe civil i FA-së për të përmbushur detyrimet në NATO. Por që gjithashtu gama e veprimtarive tona mbulon kurset intensive të gjuhës angleze, kurset e gjuhëve të dyta (gjermanisht, italisht, frëngjisht, serbisht) si dhe lëndën e gjuhës angleze për studentët e ciklit të parë bachelor në AFA.

Si funksionon tani departamenti juaj brenda AFA-së? Çfarë risie ka sjellë kjo gjë dhe në misionin tuaj? Dhe parë nga ky këndvështrim, cilat janë avantazhet apo disavantazhet, nëse mund ta themi kështu?

Brenda Fakultetit të Mbrojtjes dhe Sigurisë ne funksionojmë



Z. Bledar Vrapi, shef i Departamentit të Gjuhëve të Huaja, Fakulteti i Mbrojtjes dhe Sigurisë, AFA

si departament, gjë e cila na vendos në kornizën e arsimit të lartë dhe kjo ka avantazhet e veta edhe për ruajtjen e statusit edhe për rritjen e prestigjit por edhe të përgjegjësisë për kryerjen sa më mirë të detyrave që rrjedhin nga misioni. Por, siç përmenda më lart, veprimtaria jonë shtrihet përtej akademisë dhe e ka efektin e saj në të gjithë Forcat e Armatosura. Për shembull, Departamenti i Gjuhëve të Huaja mbështet me bazë materiale, ekspertizë, plane dhe programe edhe kurset që zhvillohen në reparte dhe njësi të tjera të forcave të armatosura si FT, KM, FA etj.

Z. Vrapi, gjatë bisedës, ju më thatë se shtyllat mbi të cilat është i ndërtuar i gjithë aktiviteti juaj janë mësimdhënia, testimi dhe përkthimi, mund të flisni pak më gjerësisht mbi këtë?

Po, janë tre shtyllat kryesore të punës mbi të cilat është i ndërtuar i gjithë aktiviteti ynë, dhe ato janë mësimdhënia, testimi dhe përkthimi.

Siç e përmenda DGJH zhvillon kurse intensive në gjuhën angleze, gjermane, italiane, frënge, serbo-maqedonase, në bazë të planit vjetor të arsimit që miratohet nga Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së. Këto kurse janë intensive, me shkëputje nga puna për një periudhë 13 javore për kurset e gjuhës angleze dhe 17-18 javë për kurset e gjuhëve të dyta. Njëkohësisht, për studentët e bachelorit në AFA, gjuha angleze është lëndë e detyrueshme si pjesë e programit dhe kurrikulës së formimit të oficerëve të rinj. Në këtë aspekt ne mbulojmë edhe mësimdhënien në këtë nivel, duke synuar përgatitjen sa më të mirë të studentëve që nesër do të jenë oficerët e ardhshëm të FA-së.

Sa i përket testimit, DGJH ka në organikë një grup për zhvillimin e testimeve dhe mbulon të gjitha nevojat e FA-së për këtë qëllim si: promovime dhe gradime, arsimim të mëtejshëm brenda dhe jashtë vendit, përzgjedhjen e kandidatave për përfaqësi apo misione jashtë vendit, në kuadër të NATO-s apo BE/OKB etj.

Një fushë tjetër e rëndësishme është edhe përkthimi, ku grupi i përkthimit mbulon ngarkesën me përkthime për MM dhe SHP në aktivitete të ndryshme si dhe përkthime me shkrim të dokumenteve të ndryshme, ku përfshihen: marrëveshje teknike për stërvitje të ndryshme, marrëveshje bashkëpunimi,

prezantime, kontrata, dokumente strategjike, STANAG të caktuar, vlerësimet e punës të personelit ushtarak në misione jashtë vendit etj. Kjo punë ka qenë voluminoze, por është përballuar me përkushtim nga stafi i DGJH.

Cilat janë synimet tuaja me qëllim që nivelet e kurseve të jenë sipas standardeve të NATO-s? Por njëkohësisht cilat janë përgjegjësitë që keni ju si departament në lidhje me këtë?

Kurset intensive të gjuhës angleze janë të niveleve të ndryshme: 2/2/2/2, 3/2/3/2, 3/3/3/3 dhe me raste edhe kurse të nivelit 1/1/1/1 apo kurse specifike si p.sh., terminologji e NATO-s, apo mbështetje për struktura të tjera të sigurisë jashtë Forcave të Armatosura. Synimi ynë është sigurisht arritja e niveleve sa më të larta të komunikimit me qëllim bashkëveprimin dhe ndërveprimin pa pengesa gjuhësore me vendet e tjera aleate dhe partnere në komunikimet e përditshme apo në trajnime, stërvitje, misione të përbashkëta.

Detyra jonë në këtë aspekt është ofrimi i kurseve gjuhësore sa më profesionale dhe me cilësi të lartë, angazhimi dhe përkushtimi i gjithë stafit për arritjen e këtyre objektivave.

Çfarë është STANAG 6001?

STANAG 6001 është një marrëveshje standarde e NATO-s për përshkrimin e aftësive gjuhësore të kërkuara nga vendet anëtare. Ky është një STANAG i ratifikuar dhe i realizuar në vazhdimësi dhe është objektivi kryesor i kapaciteteve të kërkuara nga NATO për Akademinë e Forcave të Armatosura. DGJH është struktura e ngritur për realizimin e këtij objektivi dhe siç e përmenda më lart konsiderohet i realizuar dhe është në vijimësi.

Ju jeni i vetmi institucion i FA-së, të cilit i njihen rezultatet dhe certifikatat për testin STANAG 6001 nga SHAPE, ACT dhe nga vendet e tjera të NATO-s. Sa përgjegjës ju bën ky fakt, por edhe sa krenarë njëkohësisht?

DGJH aktualisht zhvillon tre lloj testimesh: ALCPT/ELPT dhe STANAG 6001. Testimi STANAG si test ndërkombëtar zhvillohet në të katër aftësitë gjuhësore dëgjim, lexim, të folur, dhe shkrim. Për këtë qëllim DGJH ka në strukturën e tij grupin e testimit, i cili është formuar në vitin 2003 dhe është trajnuar brenda dhe jashtë vendit për standardizimin e testimit dhe kjo



bën edhe që rezultatet të njihen nga organizmat ushtarakë që ju përmendët. Kjo është arritje për ne por njëkohësisht shton ndjenjën e përgjegjshmërisë për realizimin sa më me kujdes dhe profesionalizëm të certifikimit të personelit të FA-së.

A keni ju një statistikë, apo shifër, se sa është numri i të testuarve nga ana juaj?

Po, sigurisht. Ne kryejmë një numër të konsiderueshëm testimesh për qëllimet e lartpërmendura dhe mesatarisht testojmë rreth 1200 kandidatë me testet ALCPT/ELPT dhe rreth 150 kandidatë me testin STANAG.

Kështu për shembull, gjatë vitit 2022, është kryer testimi në gjuhën angleze me testet ALCPT/ELPT për 1267 personel dhe STANAG për 128 personel i testuar.

Në gjuhët e dyta janë testuar në gjermanisht 31 personel, frëngjisht 21 personel, italisht 227 personel, dhe serbo/maqedonisht 9 personel.

A ekziston dallim midis kurseve të gjuhëve që zhvillonin, p.sh. midis gjuhës angleze, si gjuhë e parë dhe kurseve të gjuhës gjermane, frënge e të gjuhëve të tjera si gjuhë të dyta, si në mësimdhënie, por dhe në përvetësim nga ana e kursantëve?

Jo, nuk mendoj se ekziston dallim, nuk ka asnjë diferencim midis tyre. Si një nga gjuhët kryesore të komunikimit të NATO-s por edhe në arenën ndërkombëtare, pjesën më të madhe të kurseve e zë gjuha angleze me rreth 14-15, kurse intensive të niveleve të ndryshme deri tek niveli i avancuar 3/3/3/3 të shtrira në tre raunde gjatë vitit. Në gjuhët e tjera zhvillohet një kurs në vit me rreth 10 kursantë, kryesisht niveli i parë deri tek niveli i dytë sipas nevojave të FA-së. Sigurisht cilësia e mësimdhënies dhe përkushtimi nga ana e stafit dhe kursantëve mbetet e njëjtë për përvetësimin sa më të mirë të dijeve në funksion edhe të angazhimeve në punë.

Çfarë afati kohor ka një kurs që ju zhvillonin?

Kurset e gjuhës angleze zgjasin rreth 13 javë me një

program të ngjeshur nga ora 8.00 deri në 14.00, kurset e gjuhëve të dyta zgjasin rreth 17-18 javë me të njëjtin orar, angazhim dhe ngarkesë.

E gjithë periudha e vitit akademik është mjaft e ngarkuar, por sidomos periudha prill/maj/qershor, e cila përkon edhe me zhvillimet e testeve për gradim dhe arsimim/kualifikim të personelit ushtarak është ajo që ne do ta quanim si më e ngjeshur.

Me çfarë programesh punoni, cila është literatura apo kurrikulat që ndiqni?

Për kurset intensive të gjuhës angleze, literatura bazë mbi të cilën organizohet kursi janë librat amerikanë ALC (American Language Course) të cilat hartohen, përgatiten dhe përdoren edhe nga Instituti i Mbrojtjes për Gjuhët në Teksas të Shteteve të Bashkuara. Kjo metodë është e dizajnuar kryesisht duke pasur në mendje personelin ushtarak dhe terminologjinë përkatëse që u nevojitet. Njëkohësisht, librat në fjalë mbështeten me një gamë të gjerë materialesh suplementare të siguruara nga Britania e Madhe dhe materiale të përgatitura nga stafi pedagogjik i DGJH.

Në gjuhët e dyta përdoren kryesisht libra kursi bashkëkohorë, të ofruar nga partnerët përkatës për secilën gjuhë.

Cili është niveli i Burimeve tuaja njerëzore, pedagogëve, sa i kualifikuar është ai? Si veproni ju për rekrutimin e tyre?

Marrja në punë e stafit pedagogjik dhe atij mbështetës bëhet sipas procedurës standarde, që fillon me shpalljen e vendit të lirë të punës nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore në MM, shqyrtimi i dokumentacionit për përputhjen me kriteret dhe kërkesat e vendit të punës dhe në fund intervista me gojë nga një komision i përbashkët. Por ajo që është më e rëndësishme qëndron në faktin se institucioni ynë ofron trajnime të ndryshme brenda dhe jashtë vendit, ku pothuaj gjithë stafi ka marrë pjesë. Këtu mund të përmendim kurset e ofruara nga Zyra e Bashkëpunimit për Mbrojtjen (ODC) me kurset e ofruara në Institutin e Mbrojtjes për Gjuhët në Teksas të Shteteve të Bashkuara, kurset “Train the trainer”, në Akademinë ‘Schrienerham’ të ofruara nga pala Britanike, kurse kualifikimi për testimin dhe mësimdhënien në Qendrën ‘Marshall’ në Gjermani etj.

Gjithashtu stafi pedagogjik ndjek edhe kualifikime individuale për ngritjen e tyre profesionale dhe kemi aktualisht me grada shkencore një asistent profesor, gjashtë doktor dhe pjesa tjetër master shkencor.

Ajo që kemi synuar është shkëmbimi i përvojës brenda stafit të DGJH dhe për këtë qëllim kemi patur edhe një përzjerje të pedagogëve më të rinj me ato më me eksperiencë në DGJH dhe në Forcat e Armatosura në përgjithësi. Kjo i ka shërbyer përçimit të njohurive, ekspertizës, përvojës dhe frymës së duhur ndërmjet brezave.

Si zhvillohet puna shkencore në drejtim të përsosjes së programeve, metodave dhe teknikave në drejtim të mësimi, testimit apo përkthimit të gjuhëve të huaja në funksion të objektivave të FA-së?

Siç e përmendëm edhe më lart trajnimi është pjesë e vazhdueshme e fokusit tonë dhe në këtë drejtim kemi vazhduar me të njëjtën qasje. Ne kemi pedagogë që kanë ndjekur kurse posaçërisht për hartimin e programeve dhe metodave të mësimdhënies dhe këndvështrimi ynë ka qenë ndarja e këtyre praktikave më të mira me pjesën tjetër të kolektivit nëpërmjet seminareve, vëzhgimit në orën e mësimi etj.

Cili është bashkëpunimi juaj me strukturat e tjera të MM apo SHP dhe në fushën e përkthimit a punoni ju me materiale të klasifikuara, deri në çfarë niveli?

Ne bashkëpunojmë në mënyrë të vazhdueshme me SHP dhe MM, sidomos për materialet që janë për përkthim në kuadër të stërvitjeve të përbashkëta me vendet e tjera qoftë shumëkombëshe apo bilaterale. Materialet të cilat punohen nga ana jonë janë kryesisht nga burime të hapura, pra të paklasifikuara, megjithatë pedagogët e grupit të përkthimit mund të punojnë materiale deri në klasifikimin “Sekret”. Gjithsesi këto kanë qenë raste shumë të rralla.

Po me strukturat analoge të vendeve anëtare dhe partnerë të NATO-s si është bashkëpunimi? A shkëmbeni ju apo ndani eksperiencën me ta, për të implementuar programet dhe teknikat më të përparuara në drejtim të mësimi të gjuhëve të huaja?

Po, sigurisht. Kemi kontakte të rregullta në fushën profesionale sidomos nëpërmjet BILC (Bureau for International Language Co-ordination) “Zyra për Koordinimin Ndërkombëtar të Gjuhës, sidomos në fushën e standardizimit të testeve, që do të thotë një testim i zhvilluar në vendin tonë të jetë i barasvlershëm me një të tillë në një vend tjetër të NATO-s. Gjithashtu ruajmë marrëdhënie edhe me vendet e rajonit sidomos për pilotim testesh dhe shkëmbime eksperiencë në fushën e metodologjisë dhe praktikat më të mira të mësimdhënies. Gjithsesi duhet thënë se këto bashkëpunime, koordinime apo marrëdhënie duhet të jenë më të shpeshta në të mirë të punës.

Sa të përfshirë jeni ju në aktivitetet e ndryshme të FA-së, p.sh. në stërvitjet e ndryshme dhe sidomos kur këto zhvillohen edhe me partnerët e tjerë të NATO-s, kam parasysh këtu edhe stërvitjen e fundit, “Defender 2023”?

Në stërvitje të ndryshme ne jemi të përfshirë kryesisht në përkthimin e materialeve të domosdoshme si marrëveshjet apo kontratat dhe sigurisht në aktivitetet e hapjes apo mbylljes, ku asistojmë me përkthim simultan për pjesëmarrësit.

Është thënë që AFA do të ecë në gjurmët e “West Point”, për të qenë në të njëjtin nivel të programeve mësimore dhe taktike. Ku konsiston puna juaj për këtë?

Programi i gjuhës angleze për ciklin Bachelor është konsoliduar në vijimësi por sigurisht njohja me metodikat e reja të mësimdhënies, përsosja e programeve, futja e elementëve bashkëkohorë, tematika më të reja interesante për studentët, shtimi i materialeve suplementare të ngjashme me Akademinë prestigjioze të “West Point-it”, janë në vëmendjen tonë në këtë drejtim.





GJENERAL (R) PIRO AHMETAJ

Kundërofensiva e fitores së shenjtëruar nga Ukraina dhe Perëndimi

Në kapacitetin e Ekspertit të Sigurisë Kombëtare, Rajonit dhe NATO-s, kam ndjekur me interes të shtuar dhe përgjegjësi shtesë rreth 500 ditë luftime në Ukrainë, duke ndarë këndvështrime strategjike në dhjetëra konferenca të Këshillit të Atlantikut dhe Institutit të Luftës në Washington; panele me ekspertë/personalitet të sigurisë në Bruksel, Qendrën Marshall, Gjermani, Londër, Paris, Bukuresht, Sofje, Prishtinë, Varshavë, Kolegjin e NATO-s Romë, etj.

Në pamundësi për t'u dhënë përgjigje të dedikuar secilës nga mediat e interesuara, për specifikisht pritshmëritë e kundërofensivës dhe bashkë me të për fatin e luftës në Ukrainë, në vijim po paraqes një përmbledhje të përditësuar nga rreth 500 ditë të përballjes stoike të Ukrainës si dhe vendosmërisë së Aleancës Transatlantike (USA/NATO/UK/BE) në fushëbetejën me të keqen e përbashkët:

Para 16 muajsh, më 24 shkurt 2022, regjimi i Putinit iu rikthye aventurës kriminale së pushtimit të një shteti sovran nëpërmjet fuqisë armëve, duke sfiduar njëkohësisht rendit global të sigurisë, si dhe duke kërcënuar status-quonë gjeopolitike jo vetëm në rajon.

Kështu, mbas 16 muajsh, është bërë edhe më e qartë se Rusia - Putiniste e nisi agresionin ushtarak, jo vetëm me riciklimin e një ndërmarrjeje të përgjakshme (si lufta), por edhe me konceptet, armatimet dhe mendjet e ndryshkura.

Udhëheqës të deformuar nga paranojat e (mbi) pushtetit dhe nostalgjik të "lavdisë së Ushtrisë së Kuqe" në Kremlin; kamikazë anti-perëndimorë; gjeneralë të vetë (de)graduuar; sekserë të interesave të oligarkisë dhe analistë/pagatorë të gjithë-ditur në mbarë botën (përfshi në Shqipëri, etj.), e (mbi)vlerësuan fuqinë ushtarake të Rusisë me peshoren tradicionale [numër tankesh, Mig/29 (pothuaj ekuivalent me F-35), mbushje/armë bërthamore, etj.]. Për pasojë parashikuan skenarin më ogurzi: "në mos punë javësh, maksimumi muajsh do ta celebronin me "këngë e valle" fitoren e lavdishme të pushtimit të Ukrainës si dhe triumfin ndaj Aleancës Transatlantike në një paradë madhështore në Kiev më 9 maj 2022".

Falë gjakut, rezistencës heroike dhe sakrificave sublime të Ukrainës martire, asgjë nga këto nuk ndodhi.

Por çfarë është arritur dhe kush është situata mes palëve ndërluftuese mbas 16 muajsh?

Pavarësisht progresit në nivel taktik për ri-marrjen e objektivave (territoreve) apo përpjekjeve të dëshpëruara, së fundmi edhe përshkallëzimi me sulme terroriste ndaj digës së Hidrocentralit në Kakhovka apo tubacionit ndërkombëtar të amoniakut, në Kharkiv, me qëllim për të penguar kundërofensivën e përforcuar dhe të bekuar nga Perëndimi, Rusia - Putiniste ka (keq) dështuar për të arritur objektivat strategjike (pushtimin), për të mbajtur epërsinë operacionale si dhe moralin e ushtrisë.

Në të kundërt, në 16 muaj luftime të përgjakshme, Rusia rezultoi e humbur në të gjitha aspektet: "rreth 30% të territoreve të pushtuara dhe të shpallura me referendimet nën bajoneta si pjesë të Mëmës-Rusi; 200 mijë të vrarë në fushëbetejë; rreth 5 trilionë \$, ose 3 herë më shumë se Prodhimi i Përgjithshëm Neto i Rusisë për 2022 (1.7 trilionë euro); rrënuar moralin e ushtrisë, kohezionin dhe prestigjin e kombit Rus; epërsinë operacionale si dhe iniciativën strategjike!"

Nga ana tjetër, 16 muaj luftime, vërtetuan katërcipërisht, se agresioni ushtarak i Rusisë - Putiniste, nuk ishte vetëm kundër sovranitetit të Ukrainës por edhe: "kërcënim serioz ndaj rendit global të sigurisë, kufijve të demokracisë, vlerave perëndimore si dhe ndaj interesave të Aleancës Euro-Atlantike (USA/UK/NATO/BE)".

Mbas 500 ditë luftimesh të përgjakshme është vërtetuar po ashtu, (ndoshta me 2-3 përjashtime nga aktorë kontraversë por pa intuitë strategjike), se Rusia - Putiniste e ka humbur edhe betejën/shpresat për të testuar kohezionin mes 31 vendeve të NATO-s, duke përdorur gazin "si armë gjeopolitike" apo duke kërcënuar (si shtet terrorist) me fuqinë bërthamore!



Mbi 100 miliardë euro armatim dhe pajisje ushtarake moderne, zgjerimi i NATO-s në kufijtë e Rusisë me vendet Skandinave (Finlandë & Suedi), etj. janë prova të forta që demonstrojnë për kohezionin e përforcuar të Aleancës në mbështetje të sovranitetit të Ukrainës, për mbrojtjen e status-quos dhe interesave të Aleancës Transatlantike në rajon.

Kështu, mbas 16 muaj luftime të përgjakshme Rusia - Putiniste gjendet edhe më e izoluar nga mbarë bota: "nga 195 (përfshi Kosovën) vetëm 4 shtete e njohën në këtë aventure neo-naziste"; për shkak të kësaj lufte rrezikon potencialisht përjashtimin nga 5-shja vendimmarrëse e Këshillit të Sigurimit/OKB si dhe "urdhër-arresti nga gjykata ndërkombëtare" për Putinin dhe më tej për të gjithë listën e gjeneralëve dhe oborrtarëve ose "kriminelëve të luftës" rreth Tij, flasin më fortë se kërcëllimat e Mig-29, Tankeve dhe të raketave në fushëbetejë.

Nga ana tjetër, përkundër ngërdheshjeve cinike të pjellës së KGB-së, dorën e gjakosur të Putinit e refuzojnë edhe autokratët e Azisë Juglindore, ndërsa si aleatë i kanë mbetur vetëm regjimet terroriste, si Irani, Koreja e Veriut & Junta e Malit.

Nga ana tjetër, duhet thënë fatmirësisht, Rusia - Putiniste keq-dështoi për të ndezur një front të ri lufte, duke frymëzuar grupet kriminale, axhendën e politikanëve të diskretituar dhe zyrtarëve të korruptuar si dhe ekstremistët e tipit Dodik në Ballkan, apo për të ricikluar oscilacionet e Beogradit zyrtar, duke kërcënuar "deri me agresion ushtarak nën inspektimin e Ambasadorit Rus në Serbi ...!!" jo vetëm sovranitetin territorial të Republikës së Kosovës, por edhe prezencën e shtuar të NATO/KFOR-it me mision në terren?!

Po ashtu, 16 muaj luftime me "superfuqinë e kapur nga paranojat e ambicieve staliniste", gjithsesi treguan se përtej sakrificave sublime të Ukrainës fati i luftës mbetet i ndërlidhur nga fuqia e kohezionit si dhe mbështetja me armatime moderne nga Perëndimi.

Në terma financiare, paketa e mbështetjes nga Perëndimi, USA, UK, Gjermani, Norvegji dhe vendet e NATO-s (sisteme Patriot, Dronë, Tanke, Avion, etj.) e konfirmuar në prag të kundërmësymjes strategjike arrin në mbi 100 miliardë euro.

Nga ana tjetër, Samiti Historik i BE-së dhe vizita e Presidentit të SHBA-ve, Joe Biden në Kiev; pritja dhe mesazhet mbresëlënëse të Presidentit Zelensky në të gjitha kancelaritë, institucionet dhe forumet Euroatlantike, demonstrojnë vendosmërinë e palëkundur të Perëndimit për ta mbështetur

pa kompromis Ukrainën, deri në fitoren përfundimtare ndaj të keqes së përbashkët, Rusisë-Putiniste.

Po ashtu, duhet risjellë në vëmendje se në "përpjekjen e mençur" për të shmangur gjakderdhjen, Ukraina në akordancë me Perëndimin "ofruan" një qasje të moderuar në raport me anëtarësimin e Ukrainës në NATO. E thënë më thjeshtë, Shtëpia e Bardhë, Londra, Berlina, etj. fillimisht "negociuan Ukrainën neutrale ose si 'buffer zone'" mes NATO-s dhe Rusisë. Ndërsa, mbas 16 muaj luftimesh të përgjakshme, Ukraina, përsëri në sinkron me Perëndimin i është rikthyer zyrtarisht aspiratës së anëtarësimit në NATO, ndonëse Sekretari Përgjithshëm Stoltenberg i është përgjigjur "me kohën administrative/burokratike, të mbas luftës".

Me fjalë të tjera, të gjithë faktorët po projektojnë një paqe të qëndrueshme mbas përfundimit të luftës. Kështu, jo shumë vonë shpresoj ta shohim Ukrainën në tavolinën e Brukselit mes 32 vendeve anëtare të NATO-s. Ndërsa e thënë në gjuhën popullore, nëpërmjet kësaj aventure gjakatare Rusia - Putiniste: "në vend të vinte vetulla nxori dhe sytë", duke u vetë-rrethuar dhe çuar kufijtë e NATO-s, jo më shumë larg Moskës.

Në përmbyllje të sa më sipër, mendoj se me mbërritjen 90 % të paketës së armatimeve të gjeneratës së fundit nga SHBA, UK, Gjermania dhe nga pothuaj të gjitha vendet e NATO-s (tanke Abrams, Challenger, Leopard, sistemeve Patriot, Dronëve Bajraktar, Avion luftimi, etj.), është koha strategjike e duhur për të nisur kundërmësymjen e fitores së merituar nga gjaku, qëndresa heroike dhe sakrificat sublime të Ukrainasve por edhe të mbështetur dhe të bekuar nga Perëndimi.

Nga ana tjetër, kjo kundërofensivë do të shënojë vetëm fillimin e fundit të rrokullimës pa ndalim të Rusisë - Putiniste, e cila jo vetëm po e humbet me turp luftën por, sigurisht do të gjuhëzohet në përballjen me fuqinë ushtarake, kohezionin e përforcuar, vlerat demokratike dhe interesat gjeopolitike të Aleancës Euroatlantike (USA/NATO/UK/BE)!

Me këtë rast, nuk kemi pse të mos e përsërisim dhe ndihemi krenar, për rolin aktiv të Republikës së Shqipërisë, si rrjedhojë e performancës dinjitoze në Këshillin e Sigurimit të OKB-së; për solidaritetin dhe mbështetjen e pa kushtëzuar të qëndrimeve, vendimmarrjeve dhe angazhimeve të USA/NATO-s si dhe kontributeve me shumë se modeste që RSH vijon ti japë Ukrainës martire.

PËRSHTATI: MIMOZA GOLIKJA

Ministrat e Mbrojtjes të NATO-s zhvilluan një takim dyditor në Bruksel (15-16 qershor 2023) për t'u përgatitur për Samitin e Vilniusit në korrik. Ministrat trajtuan rritjen e mbështetjes për Ukrainën dhe forcimin e parandalimit dhe mbrojtjes, përfshirë planet e reja rajonale.

Duke iu drejtuar kundërsulmimit të vazhdueshëm të Ukrainës, Sekretari i Përgjithshëm tha se “Ndërsa ne takohemi, Ukraina po kryen një kundërofensivë të madhe. Është ende herët, dhe ne nuk e dimë nëse kjo do të jetë një pikë kthese e luftës, por ne shohim se ukrainasit po bëjnë përparime dhe po çlirojnë më shumë territor. Ne e dimë se sa më shumë fitime të bëjë Ukraina, aq më e fortë do të jetë dora e saj në tryezën e negociatave. Sa më shumë fitime të bëjë Ukraina, aq më shumë Presidenti Putin do të kuptojë se nuk mund të fitojë në fushën e betejës, por duhet të negociojë një paqe të drejtë”, - tha ai. “Përparimi që shohim është një dëshmi e guximit dhe përkushtimit të forcave ukrainase. Ajo tregon gjithashtu se mbështetja e ofruar nga aleatët e NATO-s po bën një ndryshim të vërtetë në fushën e betejës”.

Çfarë diskutoi takimi ministror i mbrojtjes

Ministeriali filloi me një takim të Komisionit NATO-Ukrainë, të paraprirë nga Grupi i Kontaktit të Mbrojtjes së Ukrainës, i udhëhequr nga Shtetet e Bashkuara. Së bashku me pjesëmarrjen e ministrit të Mbrojtjes ukrainas Reznikov, u trajtuan zhvillimet në terren dhe se si NATO të vazhdojë mbështetjen. Takimi diskutoi një paketë shumëvjeçare mbështetjeje, me fonde të konsiderueshme, me qëllim për të siguruar që Ukraina mund të mbrohet për një afat më të gjatë, për të kaluar nga standardet e epokës sovjetike në NATO, të arrihet ndërveprueshmëri e plotë me NATO-n dhe për të reformuar dhe rindërtuar sektorin e saj të sigurisë dhe mbrojtjes. “Ne duhet të sigurojmë që kur kjo luftë të përfundojë, të ketë marrëveshje të besueshme për sigurinë e Ukrainës që historia të mos përsëritet”, - tha Stoltenberg, për të mos lejuar që Rusia “të pushojë, të riarmatoset dhe të rifillojë një sulm të ri”. Në Samitin e Vilniusit, Aleanca do të dërgojë një mesazh të fortë mbështetjeje dhe solidariteti me Ukrainën dhe do ta bëjë të qartë se e ardhmja e Ukrainës është në NATO.

“Ministrat ranë dakord për të krijuar një Qendër të re Detare të NATO-s për Sigurinë e Infrastrukturës Kritike Nënujore brenda Komandës sonë Detare në Mbretërinë e Bashkuar. Qendra do të rrisë ndërgjegjësimin e Aleancës për situatën dhe do të rrisë praninë detare për parandalim dhe mbrojtje, nuk po e nisim nga e para, - tha Sekretari i Përgjithshëm, - e gjithë kjo punë bazohet në përshtatjen më të madhe të mbrojtjes sonë kolektive në një brez. Ne filluam gati një dekadë më parë, në përgjigje të aneksimit të paligjshëm të Krimesë nga Rusia në 2014 dhe ne duhet të vazhdojmë të përshtatemi me ritëm”, - tha ai.

Ministrat trajtuan gjithashtu se si të forcohet më tej parandalimi dhe mbrojtja e NATO-s, me plane të reja rajonale për të mbrojtur territorin aleat, me forca dhe aftësi dhe nivele të larta gatishmërie. Planet rajonale kërkojnë një strukturë të re të forcave të NATO-s. Kjo do të sigurojë mbi 300 000 trupa në gatishmëri të lartë, mbështetur nga fuqia e konsiderueshme ajrore dhe detare. “Ne do të përshtatim aranzhimet tona të komandës dhe kontrollit, që të mund të ushtrojmë planet e reja rajonale dhe t'i zbatojmë ato nëse është e nevojshme”, - tha Shefi i NATO-s.

NATO do të vazhdojë me angazhimin e saj të gjatë me industrinë e mbrojtjes transatlantike. Ministrat e Mbrojtjes u takuan gjithashtu me prodhues të vegjël, të mesëm dhe të mëdhenj të mbrojtjes nga e gjithë Aleanca. Kjo u mundësoi atyre të diskutonin drejtpërdrejt me industrinë se si të rritet më së miri prodhimi, si të sigurojnë zinxhirët e furnizimit dhe si të heqin barrierat për bashkëpunim.

Ata shqyrtuan një Plan të ri Veprimi për Prodhimin e Mbrojtjes, për të cilin liderët do të bien dakord në Samitin e Vilniusit. Plani synon të adresojë me shpejtësi mungesat në rezervat aleate, duke u mbështetur në 1 miliard dollarë prokurime të përbashkëta vetëm për municione 155 mm që po zhvillohen këtë vit nga Agjencia e NATO-s për Mbështetjen dhe Prokurimin. Plani synon gjithashtu të rrisë ndërveprimin e municioneve dhe pajisjeve të NATO-s dhe të mbështesë mbrojtjen transatlantike dhe bazën industriale. Ndërkohë që aleatët kanë përfunduar një rishikim të jashtëzakonshëm të objektivave të aftësisë kombëtare për municione vendimtare për betejën, ministrat në takim rritën objektivat në mënyrë të konsiderueshme. “Kjo do të forcojë aftësinë tonë për të mbrojtur veten dhe për të mbështetur Ukrainën dhe do t'i dërgojë një sinjal të qartë industrisë për të rritur prodhimin”, tha Stoltenberg,.

Aleatët trajtuan gjithashtu një premtim të rinovuar për investime në mbrojtje për Samitin e Vilniusit, me 2% të PBB-së për mbrojtjen si dysheme, jo tavan. Grupi i Planifikimit Bërthamor u mbledh gjithashtu gjatë takimit ministror për të “diskutuar aspektet bërthamore të mjedisit aktual të sigurisë dhe shqyrtoi përshtatjen e vazhdueshme të parandalimit bërthamor të NATO-s. “Ne vazhdojmë të shohim retorikë të pamatur bërthamore nga Rusia dhe vetëm gjatë muajve të fundit, Moska ka pezulluar pjesëmarrjen në Traktatin e Ri START dhe ka vendosur të vendosë armë bërthamore në Bjellorusi”. Ministrat diskutuan aspektet bërthamore të mjedisit aktual të sigurisë dhe morën parasysh përshtatjen e vazhdueshme të parandalimit bërthamor të NATO-s.

Ministeriali i Mbrojtjes: NATO do të fokusohet në mbështetjen për Ukrainën, duke forcuar parandalimin dhe mbrojtjen



Ky takim i ministrave të Mbrojtjes të NATO-s ishte i fundit përpara Samitit të Vilniusit, i cili do të zhvillohet më 11 dhe 12 korrik 2023. Ukraina dhe Bashkimi Evropian gjithashtu ishin pjesëmarrës në ministerial.

Shtetet e Bashkuara po udhëheqin rrugën në mbështetjen për Ukrainën

Një ditë para ministerialit të Mbrojtjes Sekretari i Përgjithshëm Stoltenberg u takua me Presidentin e SHBA-së Joe Biden në Shtëpinë e Bardhë. Takimi kishte në fokus përgatitjen për Samitin e NATO-s në Vilnius. Sekretari i Përgjithshëm falënderoi Presidentin Biden për udhëheqjen e tij dhe angazhimin e SHBA-së ndaj NATO-s në situatën më të rrezikshme të sigurisë në një brez. Ai falënderoi gjithashtu Kongresin e SHBA-së dhe popullin amerikan për mbështetjen e tyre kritike ndaj Ukrainës. Ai tha se Shtetet e Bashkuara po udhëheqin rrugën në mbështetje për Ukrainën dhe se aleatët evropianë dhe Kanadaja gjithashtu kanë ofruar dhjetëra miliarda dollarë ndihmë ushtarake, financiare dhe humanitare. Stoltenberg nënvizoi se kjo mbështetje po bën ndryshim në fushën e betejës tani, pasi Ukraina po ndjek kundërsulmimin e saj dhe punon për të rimarrë më shumë territor. “Faleminderit për udhëheqjen tuaj, për angazhimin tuaj të fortë personal ndaj lidhjes transatlantike, ndaj Evropës dhe Amerikës së Veriut që qëndrojnë së bashku dhe më lejoni të falënderoj gjithashtu Kongresin e SHBA-së dhe popullin e Amerikës për mbështetjen e fortë ndaj Ukrainës. Ju sapo bëtë një njoftim të ri për mbështetje shtesë nga SHBA-të dhe kjo është diçka që është shumë e mirëpritur”, - tha shefi i NATO-s.

Aleatët evropianë dhe Kanadaja po bëjnë gjithashtu pjesën e tyre, me dhjetëra miliarda mbështetje ushtarake dhe ekonomike për Ukrainën. Mbështetja që aleatët po i japin së bashku Ukrainës tani po bën një ndryshim në fushën e betejës, sepse ofensiva është nisur dhe ukrainasit po bëjnë përparim dhe po bëjnë përparime. Kjo mund të bëjë që Presidenti Putin në një fazë të luftës “të kuptojë se ai kurrë nuk do ta fitojë këtë luftë”.

“Lufta brutale e Rusisë nuk ishte vetë ndaj një kombi si ai i Ukrainës, nuk ishte vetëm një sulm ndaj Ukrainës, por edhe ndaj vlerave tona thelbësore, dhe ndaj njerëzve të lirë kudo. Prandaj, presidenti Putin nuk duhet ta fitojë këtë luftë, sepse kjo jo vetëm që do të jetë një tragjedi për ukrainasit, por edhe do ta bëjë botën më të rrezikshme. Ai do t'u dërgojë një mesazh udhëheqësve autoritarë në të gjithë botën, gjithashtu në Kinë, se kur përdorin forcën ushtarake, ata marrin atë që duan dhe atëherë do të bëhemi më të prekshëm”, - tha Stoltenberg në takim me Presidentin Biden.

Sekretari i Përgjithshëm tha se në Samitin e NATO-s në Vilnius muajin e ardhshëm, aleatët do të rrisin mbështetjen për Ukrainën

për një kohë të gjatë dhe do të forcojnë më tej parandalimin dhe mbrojtjen. Kjo do të përfshijë një premtim të ri dhe më ambicioz për investime në mbrojtje me 2 për qind të PBB-së si dysheme, jo tavan. Ai tha gjithashtu se mezi pret të mirëpresë Suedinë si një anëtare e plotë e NATO-s sa më shpejt të jetë e mundur. “Dhe kjo është pikërisht ajo që ne do të bëjmë kur të takohemi, të gjithë liderët e NATO-s, në samitin në Vilnius muajin e ardhshëm. Ne do të biem dakord të mbështesim dhe të shtojmë mbështetjen tonë për Ukrainën, të forcojmë më tej parandalimin dhe mbrojtjen tonë, duke përfshirë angazhimin e ri për të investuar më shumë në mbrojtje. Dhe unë pres që aleatët të bien dakord që 2% e PBB-së për mbrojtjen duhet të jetë minimumi i asaj që Aleatët duhet të investojnë në sigurinë tonë të përbashkët. Ne do të forcojmë partneritetin tonë me partnerët tanë Indo-Paqësor dhe më pas, sigurisht, të gjithë presim me padurim të mirëpresim Suedinë si një anëtare e plotë e Aleancës sa më shpejt të jetë e mundur”, - tha ai.

Ne do të mbrojmë çdo pëllëmbë të territorit të NATO-s, - tha Presidenti i SHBA Joe Biden. “Ne kemi forcuar gjithashtu edhe krahun lindor të NATO-s. E kemi bërë të qartë se do të mbrojmë çdo pëllëmbë të territorit të NATO-s. E them përsëri, angazhimi i Shteteve të Bashkuara në Nenin 5 të NATO-s është i fortë”, - theksoi presidenti amerikan. “Në samitin tonë në Lituani muajin e ardhshëm, ne do të ndërtojmë atë vrull nga puna për të siguruar që aleatët të shpenzojnë mjaftueshëm për mbrojtjen, 2% jo vetëm si tavan, por si dysheme. Për angazhimet e NATO-s gjithashtu, siç e dini, unë ju kam mbajtur plotësisht të informuar për diskutimet e mia me Japoninë dhe Korenë e Jugut në Paqësor, mendoj se është hera e parë që ne kemi pasur një fuqi të madhe të Paqësorit të angazhuar në trajtimin e agresionit në Evropë”, - tha Presideti Biden.

Suedia në NATO, sa më shpejt të jetë e mundur

Ndërsa ishte në Uashington, Sekretari i Përgjithshëm u takua veçmas me Sekretarin e Shtetit Antony Blinken dhe e falënderoi atë për udhëheqjen e SHBA-së në një kohë kritike për sigurinë tonë. Ai u takua gjithashtu me udhëheqësin e pakicës së Senatit Mitch McConnell dhe një numër senatorësh të tjerë amerikanë. Ai falënderoi Shtetet e Bashkuara për angazhimin e tyre për forcimin e lidhjeve transatlantike dhe mbështetjen e dhënë Ukrainës.

Sekretari i Përgjithshëm vuri në dukje se mbështetja që aleatët dhe partnerët e NATO-s po i japin Ukrainës po bën një ndryshim në fushën e betejës dhe ka mundësuar kundërofensivë ukrainase tani në zhvillim. Ai theksoi se në Samitin e Vilniusit në korrik, krerët e NATO-s do të mbështesin dhe rrisin mbështetjen për Ukrainën. Ata do të marrin gjithashtu vendime për të forcuar më tej parandalimin dhe mbrojtjen e NATO-s, duke përfshirë një angazhim më të fortë për të rritur shpenzimet e mbrojtjes. Stoltenberg tha se mezi pret të mirëpresë Suedinë si një anëtare e plotë të NATO-s, sa më shpejt të jetë e mundur.

Në deklaratën e përbashkët me Sekretarin e Përgjithshëm të NATO-s, Sekretari amerikan i Shtetit Antony J. Blinken tha se Samiti i Vilniusit muajin e ardhshëm, ishte një moment historik shumë i rëndësishëm për të gjithë Aleancën dhe se për të mbrojtur çdo centimetër të territorit të NATO-s, Aleanca do të ripohojë angazhimin e saj, Nenin Pesë. NATO do të ndjekë angazhimin për të përforcuar investimet e saj në mbrojtje, për të forcuar edhe më shumë aftësinë parandaluese dhe mbrojtëse të Aleancës dhe për të funksionalizuar shumë nga planet dhe programet në Konceptin Strategjik, i cili po “përpunohet përpara Samitit”. Ai tha se parashikonte gjithashtu një paketë të fuqishme të mbështetjes politike dhe praktike për Ukrainën. Z Blinken tha se “është koha për të mirëpritur Suedinë si anëtarin e ardhshëm të Aleancës, pasi ka pasur një proces të rëndësishëm dhe mendoj shumë të përshtatshëm për anëtarësim për të adresuar shqetësimet e dhura të aleatëve të tjerë. Aleanca do të forcojë edhe më shumë partneritetin tonë me vendet në Indo-Paqësorin, në mënyrë që të ketë një axhendë të gjerë dhe të thellë. Detajet janë të rëndësishme dhe ne do të vazhdojmë të punojmë për to në javët në vijim”, - tha ai.

NATO po përgatitet për Samitin e ardhshëm të saj në Vilnius. Edhe atje aleatët do të bien dakord për të mbështetur dhe rritur mbështetjen për Ukrainën, për të forcuar më tej parandalimin dhe mbrojtjen, e cila përfshin më shumë një angazhim më të fortë për të rritur shpenzimet e mbrojtjes. “Pres që aleatët të bien dakord që 2% e PBB-së për mbrojtjen duhet të jetë një minimum dhe sa ne të gjithë duhet të investojmë në mbrojtjen tonë, në sigurinë tonë kolektive. Ne do të forcojmë partneritetin tonë me partnerët Indo-Paqësor. Sigurisht, ne të gjithë presim me padurim të mirëpresim Suedinë si një anëtare e plotë e Aleancës sa më shpejt të jetë e mundur”, - tha Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Stoltenberg.

Përgatitja e oficerit shqiptar, liderit me karakter



Dr. Valbona Zeka,
Fakulteti i Mbrojtjes dhe Sigurisë

Ndryshimet rrënjësore në mjedisin strategjik të sigurisë, padyshim që diktojnë zhvillimin e forcës, reformimin dhe modernizimin e tyre, nivelin e gatishmërisë, aftësisë për të qenë ndërveprues, të qëndrueshëm dhe efikas në operacionet me vete apo me aleatët, si dhe doemos kërkojnë një trupë ushtarake profesionale dhe të mirë trajnuar.

Këto ndryshime përherë dhe më shumë diktojnë nevojën e evoluimit dhe zhvillimit të procesit të arsimimit, trajnimit dhe stërvitjes për përgatitjen e personelit të Forcave të Armatosura, për një spektër të plotë në zgjidhjen e detyrave në fushën e operacioneve.

Përgatitja profesionale duhet të ngrihet vazhdimisht, përvoja dhe mësimet e kaluara, duhet të përdoren për të dritësuar objektivat për të ardhmen. Institucionet arsimore e stërvitore dhe veçanërisht Akademia e Forcave të Armatosura, në përgatitjen e programeve të studimeve dhe kurrikulave, duhet të mbajë në konsideratë baraspeshën e duhur mes koncepteve akademike universitare dhe realitetit operacional me qëllim realizimin e efektit të duhur në përgatitjen e gjeneratës së re të oficerëve.

Forcat e Armatosura duhet të ndërmarrin veprime për të përmirësuar aftësitë luftuese të trupës së saj, të oficerëve dhe të nënoficerëve në mënyrë që të vazhdojnë të operojnë në rrugë të efektshme në këta misionë shumë të rrezikshme, e në mjedise lufte jo të zakonshme.

Kërcënimet ndaj sigurisë, të cilat janë më të ndryshme, më të vështira për t'u parashikuar dhe neutralizuar, kërkojnë që institucionet e arsimimit dhe trajnimit të përshtatin programin e tyre për të nxjerrë oficerë, nënoficerë dhe ushtarë të përgatitur të aftë të orientohen në të gjitha llojet e luftës sot.

Ndryshimi i formave të konfliktit, kërcënimet dhe rreziqet me natyrë jo konvencionale apo terrorizmi, siguria energjetike, kërcënimet kibernetik dhe ndryshimet klimaterike, sfidat dhe kërcënimet hibride, përhapja në rritje e luftës asimetrike, krahas me armët e taktikat konvencionale e jo konvencionale në fushëbetejë, kërkojnë gjithnjë e më shumë një angazhim të vazhdueshëm të Forcave tona të Armatosura dhe një trajtim gjithëpërfshirës ndaj operacioneve për përballimin e kërcënimeve e rreziqeve të reja, si dhe reflektim e ndikim në përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit arsimor ushtarak, doktrinës ushtarake dhe edukimit profesional të ushtarakut në veçanti. “Mjedisi ynë i sigurisë është më kompleks dhe i kontestuar më shumë se kurrë më parë, me konkurrencën globale, sulmet e sofistikuar kibernetike, teknologjitë përçarëse, terrorizmin brutal, përhapjen e armëve bërthamore dhe ndikimet e ndryshimeve klimatike ndaj sigurisë.”

Ky mjedis ka sjelle një dinamikë të re të operacioneve të sotme, por dhe te ardhme. Nëse hedhim një vështrim të dekadës së fundit do të shohim se ka pasur ndryshime të jashtëzakonshme gjeopolitike dhe gjeostrategjike, të cilat kanë prodhuar një doktrinë të re të aktorëve kryesorë



global dhe një konceptim të ri të përdorimit të forcës ushtarake. Shembull më domethënës i këtyre ndryshimeve në dekadën e fundit është edhe agresioni i fundit ushtarak rus ndaj një vendi të pavarur siç është Ukraina, ku po zbatohen të gjitha format e luftës, diversive, hibride, kibernetike, asimetrike e deri tek ato konvencionale klasike.

Përgatitja profesionale si një proces i vazhdueshëm

Në këto rrethana, ngritja profesionale e ushtarakut shqiptar merr një rëndësi të dorës së parë. Programi i dijes, përgatitja profesionale e oficerëve, nënoficerëve dhe ushtarëve është një proces i qëllimshëm, i vazhdueshëm, i ndarë në faza progresive. Ai është një proces nëpërmjet të cilit, studentët shndërrohen nga qytetare civilë në ushtarë profesionistë të përgatitur dhe në drejtues të aftë, si oficerë për të komanduar operacione ushtarake, për të drejtuar ekupe dhe organizata në zbatimin e detyrave me përpikëri në kohë.

Ecuria profesionale arrihet nëpërmjet sintezës së vazhdueshme të njohurive, aftësive dhe eksperiencës së fituar nëpërmjet trajnimit institucional dhe realizimit të programeve të studimit, trajnimit ekstrakurrikular, detyrave/eksperiencës operacionale dhe vetëzhvillimit. Themelet e zhvillimit profesional të ushtarakut e kanë bazën e dijes tek shkolla. Akademia e Forcave të Armatosura është struktura kryesore e cila mbështet Forcat e Armatosura me burime njerëzore të arsimuara, trajnuara dhe të kualifikuara.

Nëpërmjet sistemit të arsimimit dhe stërvitjes, Forcat e Armatosura u japin njësive të tyre specialistë; ushtarakë dhe drejtues të stërvitur, shumë të përshtatshëm, të gatshëm për të kryer misionet bazë operacionale dhe funksionale të kohës së luftës. Një sistem arsimor dhe trajnues i mirë përqendruar dhe i organizuar përgatit profesionistë ushtarakë të suksesshëm në fushëbetejë. Ky sistem, gjithashtu, i përgatit profesionistët ushtarakë për detyra më komplekse dhe pozicione përgjegjësie gjithnjë e më të mëdha.

Arsimimi dhe trajnimi në mënyrë parësore përfshin bazat, qendrat trajnuese dhe infrastrukturën akademike, të cilat kryejnë stërvitjen fillestare dhe plotësojnë arsimimin e mëtejshëm profesional për studentet dhe drejtuesit specialistë.

Aftësitë ushtarake që kërkohen sot për misionet të tilla janë komplekse dhe duhet të pasqyrohen në programet studimore, në programet ekstrakurrikulare dhe në doktrinën e arsimimit, sepse Forcat e Armatosura janë dhe mbeten një mjet efektiv i politikës së sigurisë.

Natyrë e profesionit ushtarak është e tillë që, aftësitë e ushtarakut janë të bazuara në përgjegjësitë maksimale të tij ndaj detyrës, si dhe kualifikimin e aftësimin e tij, për të kryer me përpikëri detyrën apo misionin e ngarkuar sipas funksionit që ka. Sistemi profesional i përgatitjes në akademi siguron që oficerët e ardhshëm të jenë të stërvitur, të edukuar, të përgatitur për t'u bërë drejtues të suksesshëm. Një program efektiv dhe i arrirë i arsimimit ushtarak përgatit drejtuesit për përgjegjësitë e shtruara dhe vendos kushtet për të aftësuar ata që të arrijnë rezultate të suksesshme në hierarkinë e komandimit.

Forcat e Armatosura kanë nevojë për drejtues, që të jenë profesionistë dhe të aftë të veprojnë në zona shumë larg njëra - tjetrës, në mjedise të ndryshme dhe të integruara në forca operacionale të bashkuara, kombëtare, shumëkombëshe dhe të përfshira, si edhe me forcat e operacioneve speciale dhe organizatat joqeveritare. Këta drejtues dhe ushtarakë profesionistë kërkohet të jenë më karakter të fortë moral, të jenë të vetëdijshëm dhe të përshtatshëm, të qetë në situata të pasigurta, të aftë të presin dhe zbatojnë urdhra, të vijojnë nga veprimet e tyre, të dedikuar në profesionin e ushtarakut dhe të jenë shumë të aftë psikologjikisht dhe fizikisht në çdo rrethanë.

Përgatitja profesionale është proces i vazhdueshëm që zhvillohet në Akademinë e Forcave të Armatosura, i cili u jep kandidatëve për oficerë nëpërmjet programeve të studimit, të gjitha nivelet (ciklet) e studimit nga bachelor, master shkencor dhe doktoraturë. Procesi merr në konsideratë së pari, drejtuesit ushtarakë dhe profesionistët, që të jenë teknikisht dhe taktikisht të aftë në kompetencat e tyre bazë, të përshtatshëm për ndryshimin.

Dallimi i ndryshimit ndërmjet stërvitjes reale dhe operacionale apo performancës së fushëbetejës është e vështirë. Zhvillimi i koncepteve akademike universitare si qellim më vete, mund të heqë vëmendjen nga objektiva të mirëfilltë ushtarakë dhe anasjelltas. Në këtë pikëpamje qëllimi kryesor në përgatitjen e programeve të studimit ka qenë dhe është

ndërturja e këtyre dy koncepteve njeri me tjetrin, si dhe zhvillimin veçmas të programit të karakterit për të krijuar në tërësi një program studimor efektiv për studentët.

Aftësimi i liderit profesional arrihet nëpërmjet disa fushave, të cilat japin eksperiencën e duhur gjatë zhvillimit në karrierë. Fusha e parë dhe më esenciale është shkolla, e cila nuk ka qëllim të nxjerrë oficerë të mësuar, por oficerë që dinë të mësojnë. Më tej me rëndësi jo të paktë është përvoja në punë, vetëzhvillimi dhe këshillimi. Këto katër fusha ndërliken, duke përdorur informacionin e marrë dhe vlerësimet nëpërmjet burimeve dhe metodave të ndryshme. “Profesioni ushtarak për shkak të edukimit dhe të shkollimit të theksuar ka një respekt për arritjet intelektuale...

Menaxheri ushtarak duhet të jetë i përgatitur për të vënë në përdorim arritjet e tij intelektuale, sepse ai është i interesuar për zgjidhje shkencore produktive të problemeve komplekse administrative dhe organizative”.

Pikërisht qëllimi i Akademisë së Forcave të Armatosura është që nëpërmjet programeve të japë bazën e shëndoshë, mbi të cilën mbështetet i gjithë zhvillimi profesional i së ardhmes së oficerit. Synimi është në zhvillimin e programeve të gjithë cikleve të ruhet progresiviteti për zhvillimin e kompetencës taktike, teknike dhe fizike, si edhe dimensionet qendrore të udhëheqjes.

Modeli ideal për procesin e zhvillimit të drejtuesve brenda arsimimit dhe trajnimit institucional është zhvillimi në grupin e vogël në zgjidhjen e detyrave, ku theksi vihet në pjesëmarrjen e studentit dhe kontributin e procesit mësimor. Ushttrimet në situata të caktuara taktike, fizike, operacionale apo dhe strategjike, seminarët e lidershit dhe ushttrimet e planifikimit për momentet e krizave janë disa shembuj të arsimimit dhe trajnimit efektiv të grupeve të vogla.

Formimi i liderit me karakter

Shërbimi në Forcat e Armatosura, duke filluar në moshën rinore nuk mund të shihet ndryshe vetëm si një formë e edukimit moral. Shprehja gjermane “Die Schule der Nation” (Shkolla e Kombit) në fakt shpreh një apel të shërbimit ndaj kombit, i cili ofrohet përpos një përgatitjeje profesionale edhe shpirt të unifikuar kombëtar. Forcat e Armatosura ngulisin në personelin ushtarak virtytet dhe shprehitë e të menduarit dhe të vepruarit me vlera të larta morale, etike dhe profesionale.

Ushtarakët profesionistë dhe ushtritë profesioniste mund t'i bashkëngjiten kodeve të sjelljes e të mendimit e të lulëzojnë edhe në mjediset e një shoqërie indiferente ose armiqësore”.

Qëllimi përfundimtar i aftësimit profesional, padyshim që është formimi i drejtuesve kompetentë dhe i ushtarakëve profesionistë. Këta drejtues dhe ushtarakë profesionistë do të japin shumë qartë qëllimin, drejtimin, motivimin dhe një vizion për vartësit e tyre, ndërsa zbatojnë misionet funksionale të kohës së luftës dhe operacionet e kohës së paqes.

Lidershipi ka një rol të rëndësishëm në ngritjen profesionale të studentëve tanë gjatë procesit të zhvillimit të programeve të studimit. Studentët janë gati të ndjekin një drejtues, në vendosmërinë dhe aftësitë drejtuese të të cilit ata kanë besim. Vendosmëria është një nga cilësitë kryesore të udhëheqjes së frytshme. Kur një drejtues, i cili ndryshon gjithnjë vendimet dhe urdhrat e tij, nuk do të vonojë të humbasë çfarëdo besimi që ushtarët e tij mund të kenë patur më përpara. Vendosmëria lidhet me zotërimin e profesionit dhe dijeve ushtarake.

Një pedagog dhe drejtues i mirë duhet të ketë njohuri përpos programit akademik edhe për

atë të karakterit, natyrën e njeriut dhe parimet që lidhen me sjelljen njerëzore. Kjo sjellje e bën drejtuesin të jetë më pranë shpirtit dhe mendjes së vartësve të vet. Duke njohur anët e brendshme, hallet dhe shqetësimet e vartësve e bëjnë drejtuesin të parashikojë dhe kontrollojë sjelljen e njerëzve që udhëheq dhe drejton. Skendërbeu ishte jo vetëm një komandant dhe strateg i shquar ushtarak, por ai ishte edhe një drejtues dhe psikolog që njihte mirë artin e të bërit për vete komandantët dhe ushtarët vartës të tij. Kjo qasje ka ndikim në zhvillimin e karakterit të studentit, duke kultivuar tek ai kompetencën shoqërore, sociale dhe profesionale.

Në këtë kontekst zhvillimi i karakterit tek studentet ka një rol vendimtar në formimin e ardhshëm të oficerit. Motoja e Akademisë “West Pointit”, me të cilën jemi duke bashkëpunuar është se, “Askush nga ne nuk mund të thotë, kjo është përgjegjësi e dikujt tjetër. Edukoni, trajnioni dhe frymëzoni Korpusin e Kadetëve, në mënyrë që çdo i diplomuar të jetë një lider i porositur me karakter i përkushtuar ndaj vlerave të Detyrës, Nderit, Vendit dhe i përgatitur për një karrierë të përsosmërisë profesionale dhe shërbimit ndaj Kombit si oficer në Ushtrinë e Shteteve të Bashkuara”.

Akademia e Forcave të Armatosura, krahas zhvillimit të programit akademik, rëndësi të madhe po i kushton zhvillimit të programit të karakterit. Qëllimi i këtij programi është se si ai të formësojë/ndërtojë dhe përshkruajë liderët me karakter, të cilët të jenë të brendësuar me idealet e Detyrës, Nderit, Etikës ndaj Forcave të Armatosura dhe Atdheut.

Synimi për çdo të diplomuar do të jetë krijimi i liderit me karakter, i përkushtuar ndaj vlerave të Detyrës, Nderit, Atdheut dhe i përgatitur për një karrierë të suksesshme profesionale dhe shërbimit ndaj Kombi si oficer.

Akademia e Forcave të Armatosura në formimin e gjeneratës së re të oficerëve ka si pikësynim për të diplomuar individë që janë të certifikuar në karakterin (Nderin), kompetencën (Detyrën) dhe angazhimin (Përkushtimin ndaj vendit) të një oficer i ngarkuar në profesionin e ushtrisë.

Në këtë kuadër, të gjitha strukturat akademike dhe komanduese të AFA-së kanë një përgjegjësi kryesore për të ndikuar në formimin/ndërtimin e karakterit ose të lehtësojnë zhvillimin e karakterit në secilin individ gjatë periudhës 4-vjeçare të studentit në akademi.

Në strategjinë e zhvillimit të karakterit në radhë të parë duhet të synohet shndërrimi i studentit/kadetit nga “njeri civil” në “njeri me uniformë” të përshtatur me disiplinën, rregulloret, rregullat e brendshme, kodin ushtarak, që tregojnë formësimin e idealeve të tij, ndaj Detyrës, Nderit dhe Atdheut. Pas këtij hapi do të jetë e gjithë veprimtaria programore e kurrikulare e nevojshme dhe që vlerëson periodikisht efektivitetin e strategjisë, duke mundësuar kushtet për integrimin, sinkronizimin dhe vlerësimin individual dhe kolektiv të studentëve.

Zhvillimi i programit të karakterit do jetë i ndërthurur në të gjitha programet e tjera për të gjitha ciklet e studimit. Ai duhet të zhvillohet natyrshëm nga secili drejtues apo pedagog i stafit akademik. Drejtimi ka shumë rëndësi në veprimtarinë akademike dhe mësimore. Drejtimi përbën artin e sjelljes me njerëzit me objektiv që drejtuesi të ndikojë tek ata, duke i bindur të veprojnë në drejtimin e duhur. Drejtimi nuk duhet ngatërruar me detyrimin, ato janë dy gjëra diametralisht të kundërta. Le të kujtojmë shprehjen e famshme të Uellingtonit: “Mua më pëlqen t’i bind njerëzit dhe jo të ushtroj një autoritet mbi ta”.

Në këtë kontekst, zhvillimi i këtij programi kërkon në radhë të parë njerëz të përkushtuar, me integritet dhe moral të lartë. Shembulli personal është kontributi më i mirë në zhvillimin e programit të karakterit dhe formësimin e njerëzve profesionalë dhe liderëve me karakter. Sa më i drejtë dhe i ndershëm, sa më shumë dinamizëm dhe këmbëngulje të shfaqë një drejtues përpara vartësve të tij, aq më shumë autoritet, respekt dhe dashuri do të fitojë ai prej tyre.

Kjo sjellje e bën atë një shembull dhe model të një njeriu që nuk bën ndarje dhe vlerësimë të dyshimta. Ata shohin se si dënimi dhe falënderimi janë të merituar dhe vlerësimi i komandantit

të tyre është i padiskutueshëm. Vartësit e respektojnë këtë sjellje dhe i ndjekin me besnikëri këta udhëheqës dhe drejtues sepse ata kuptojnë se, kjo lidhet me të gjithë dhe është në interes të të gjithëve.

Gjenerali Robert Li ishte jo vetëm një udhëheqës dhe komandant i shquar në betejat që zhvillonte, por autoriteti i tij ishte fituar edhe për sjelljen dhe qëndrimin e dashur që tregonte ai për oficerët dhe ushtarët vartës të tij. Për ushtarët ai ndjente detyrimet më të mëdha. Ai i quante ata krenaria e tij. Ai përpiqej gjithnjë për mirëqenien e tyre. Ishte kjo arsyeja pse ushtarët e tij kishin një nderim, një devocion dhe një afeksion që pak udhëheqës ushtarakë e kanë gëzuar. Edhe pse ai nuk e pranonte këtë vlerësim, ai e kishte fituar me meritë atë.



Duke folur për aftësitë dhe autoritetin që duhet të gëzojë një drejtues, Karl Fon Klauzeviçit theksonte se: “Funksioni i parë i komandantit është të frymëzojë e të nxisë ushtarët për të bërë gjëra të vështira, në rrethana të vështira”.

Arsimimi është procesi i dhënies së njohurive dhe aftësive intelektuale me të cilat informacioni mund të përkthehet në një mënyrë të arsyeshme duke përdorur gjykimin e shëndoshë. Arsimi është në thelb instruksioni formal, zakonisht i kryer në mjedise klase, me njohuri të shtuara, aftësi, mendim kritik, me vendimmarrje të përmirësuar dhe/apo përvojë si produkti i dëshiruar për studentin. Kjo metodologji është në kontradiktë me stërvitjen, ku një detyrë bazë apo stërvitje përdoret në kushte specifike dhe, këtu standardet përdoren për të vlerësuar aftësitë e individit dhe të njësisë operacionale.

Zhvillimi i programeve dhe arsimimi mbështeten në aftësi, përvojë dhe ekspertizë, që drejtuesit e fitojnë në Akademinë e Forcave të Armatosura dhe kurset e trajnimit e ndryshme civile apo ato ushtarake, të kryera në vendet partnere dhe ato të NATO-s.

Nëpërmjet procesit të arsimimit në të tria ciklet e studimit dhe më tej në kurset e karrierës, studentët marrin njohuri të qëndrueshme për të kryer detyra të vështira ndërsa mësojnë vlerat, karakterin, aftësitë dhe veprimet thelbësore për drejtimin me cilësi të lartë dhe profesionalizëm. Kur të njëjtat përmasa të drejtimit testohen, aplikohen dhe përforcohen, atëherë ato forcohen nga kërkesat operacionale në vazhdimësi dhe programet e mira të vetëzhvillimit, ku drejtuesit fitojnë dhe ruajnë kompetencën e vërtetë në profesionin e tyre.

Është i njohur fakti që baza e një fuqie ushtarake është trekëndëshi i njohur force-moral-motivacion. Kur flasim për komponentin e forcës duhet të theksojmë se krahas pajisjes me armatim dhe teknologji një vend të rëndësishëm zë përgatitja e personelit ushtarak dhe në veçanti përgatitja fizike. Në përcaktimin e fuqisë luftarake ka pak rëndësi sa të përparuara janë platformat, armatimet ose

pajisjet e njësive ushtarake, nëse njerëzit që i drejtojnë ato janë të pamotivuar, janë të pa stërvitur ose u mungon udhëheqja e duhur.

Sot, Forcat e Armatosura të Shqipërisë janë të angazhuara në mjaft detyra operacionale dhe për pasojë ato janë dislokuar në misione brenda vendit, ashtu edhe në misionet paqeruajtëse, ku për pasojë nuk gjejnë kohë të mjaftueshme për të bërë përgatitje fizike dhe stërvitje të programuara si në kohë normale.

Programet akademike, ushtarake, fizike dhe të karakterit që ofrohet Akademia përbëjnë mjetet kryesore për të zhvilluar tek trupa ushtarake, pesë aspektet e karakterit individual dhe rritjen e performancës profesionale. Programi Akademik ka synime kryesore të zhvillimit të karakterit në pikëpamjen morale,

sociale dhe aspektet e tjera të zhvillimit të qytetarisë. Programet e tjera kontribuojnë në qëllimet kryesore dhe mbështetëse të karakterit bazuar në aktivitetet e tyre.

Akademia e Forcave të Armatosura, nëpërmjet zhvillimit të Programit Fizik është fokusuar në performancën dhe aspektet e lidërshit të karakterit, duke bërë të mundur rritjen e rezistencës fizike dhe mendore, duke forcuar guximin përmes vështirësive individuale dhe në grup, duke zhvilluar një shpirt fitues dhe duke demonstruar më të mirën sportive. Stafii pedagogjik dhe personeli komandues, oficerët përgjegjës sfidojnë dhe frymëzojnë studentët për të rritur performancën dhe karakterit e tyre drejtues.

Pjesëmarrja aktive në sporte, klube konkurruese në disiplina të ndryshme sportive si atletikë, gjimnastikë, futboll, volejbol, basketboll etj., krijon mundësi dhe i ofron çdo student një mundësi të përditshme për t’u zhvilluar fizikisht, mendërisht dhe nga ana etike.

Por ama, në çdo kohë është tepër i domosdoshëm kondicioni fizik. Kondicioni fizik, si komponent i performancës sportive, formohet nga veprimi i përbashkët me përparësi i proceseve energjike, duke shfaqur si aftësinë e forcës, shpejtësisë, qëndrueshmërisë dhe lëvizshmërisë artikulare, në bashkërendim me cilësitë e domosdoshme psikike të këtyre aftësive.

Ushtrimet fizike që ushtrojnë studentët në terrene sportive apo palestër, padyshim i bëjnë ata të aftë fizikisht dhe në të njëjtën kohë u nevojiten atyre për të kryer detyra sa më të vështira, si për shembull, marshimet në distanca të gjata, në zhvillimin e stërvitjeve komplekse ose operimi në zona që nuk janë lehtësisht të lundrueshme. Në këtë kuadër, studime të shumta të kryera kanë dalë në përfundimin se, përgatitja fizike iu mundëson individëve që të ushtrojnë rregullisht atë, një numër të madh mundësish dhe benefitesh që përfshijnë, jo vetëm kontrollin e fizik, por një gjendje të mirë shëndetësore, përmirëson humorin dhe anën moralo-psikologjike dhe

anën karakteriale.

Trupa pedagogjike në Akademi, por dhe drejtuesit në strukturat e FA-së, duhet të organizojnë fushata të trajnimit fizik për të promovuar aftësi të besueshme profesionale për trupat e tyre, në mënyrë që ata të mund të përballen me çdo lloj ngjarjeje, veçanërisht ato që ndodhin në mënyrë të papritur.

Padyshim, kjo është një përgjegjësi në radhë të parë e çdo ushtaraku në mënyre individuale, por edhe e strukturave drejtuese të përgatitjes fizike në të gjithë piramidën e Forcave të Armatosura.

Në studimet e ndryshme të kryera në SHBA, rezultati i këtij edukimi drejtues është përputhja e përmirësuar me programimin e përgatitjes fizike, me shpërndarjen e burimeve, duke bërë kështu një ulje të gjasave për sëmundje fizike dhe psikologjike të studentëve. Këto rezultate ndodhin kur udhëheqësit kuptojnë vlerën dhe dobinë e këtij sistemi.

Vetëdija apo përgatitja e pedagogëve dhe drejtuesve në akademi me ndikim në opinionin e komunitetit akademik për perspektivën, vlerat dhe prioritetet e Akademisë së Forcave të Armatosura kërkon patjetër modelimin e një kulture dhe vlerave brenda strukturave tona akademike, por edhe më gjerë në rrafshin shoqëror.

Një aspekt tjetër shumë i rëndësishëm në veprimtarinë mësimore dhe akademike në AFA është udhëheqja me shembullin personal. Një gjeneral i spikatur amerikan thoshte se: “Në arenën në të cilën jeton dhe vepron drejtuesi i lartë i ushtrisë, ju duhet të jeni bindës me audienca të ndryshme. Ju duhet të jeni bindës me audiencën e brendshme të ushtarakëve dhe civilëve që shërbeni...”.

Duke lexuar me kujdes shembujt e shumë komandantëve të suksesshëm dhe me autoritet, vëmë re se një ndër cilësitë që i ka bërë ata të jenë të tillë ka qenë energjia dhe shembulli personal që ata kanë treguar. Shembulli i gjeneral Stillull për drejtimin dhe realizimin me sukses të marshimit prej 140 milje nga Burma për në Indi, nën drejtimin e jo një reparti të rregullt ushtarak por të një turme të paorganizuarish burra dhe gra, është një model që tregon se, atje ku shembulli personal, qëndrueshmëria fizike dhe energjia e komandantit udhëheq, vartësit të ndjekin dhe vlerësojnë autoritetin me të cilën drejton.

Komandat e njësive ushtarake dhe drejtuesit e të gjitha niveleve duhet të ruajnë infrastrukturën e përgatitjes fizike dhe ndërkohe të ndërtojnë objekte të reja shtesë të trajnimit fizik, në mënyrë që të inkurajojë sa më shumë personelin ushtarak dhe civil në Forcat e Armatosura që të bëjnë sa më shume përgatitje fizike, duke ndikuar drejtpërdrejtë në përmirësimin e mirëqenies së tyre.

Ngjarjet dhe fenomenet në fushën ushtarake kanë karakter historik, ato varen, zhvillohen e kushtëzohen nga sistemi shoqëror. Mjedisi i sigurisë, niveli i zhvillimit të teknikës dhe armatimit, mënyrat e reja të zhvillimit të veprimeve luftarake të ndërlikuara ndikojnë drejtpërdrejtë në strategjitë e doktrinat ushtarake të drejtimit. Kryerja me sukses e operacioneve ushtarake kërkon një doktrinë të qartë dhe kjo është veçanërisht e rëndësishme, kur operacionet do të kryhen nga forca aleate ose të koalicionit. Dhe kjo arrihet në pasurimin e kurrikulave arsimore, nëpërmjet futjes së doktrinave të reja të NATO-s dhe në të njëjtën kohë zhvillimin e pasurimin e doktrinës ushtarake kombëtare.

- Akademia e Forcave të Armatosura, nëpërmjet zhvillimit të programit akademik dhe programit të karakterit, merr një rol parësor në ngjizjen e aftësive moralo-psikologjike tek trupa studentore si garantuese e lidërshit të ardhshëm të suksesshëm.

- Autoritetin drejtues, nuk e jep pozicioni komandues/drejtues apo gradat ushtarake, as trashëgimia familjare, por ta japin vlerat etike, morale dhe profesionale.

- Autoriteti është vetëm produkt i edukimit, karakterit, punës dhe sjelljes individuale të një drejtuesi ushtarak.

- Profesioni i ushtarakut merr vlera të tjera dhe mund të themi se, nga përvoja e misioneve shqiptare dhe atyre të vendeve euroatlantike dhe partnere, ato duhet të jenë në një konvergencë sa më të lartë me vlerat civile.

BE: Nxitje të riciklimit në 18 shtete anëtare që rrezikojnë të humbin objektivat e mbetjeve

Komisioni European, në një raport të publikuar së fundmi, identifikon shtetet anëtare që rrezikojnë të mos përmbushin objektivat e përgatitjes për ripërdorimin dhe riciklimin e vitit 2025 për mbetjet bashkiake dhe të të gjitha paketimeve dhe objektivin e 2035 për depozitim të mbetjeve. Nëntë shtete anëtare janë në rrugën e duhur për të përmbushur objektivat e vitit 2025: Austria, Belgjika, Çekia, Danimarka, Gjermania, Italia, Luksemburgu, Holanda dhe Sllovenia.

Megjithatë, 18 shtete anëtare rrezikojnë të humbasin një ose të dyja objektivat e vitit 2025. Estonia, Finlanda, Franca, Irlanda, Letonia, Portugalia, Spanja dhe Suedia janë në rrezik për të humbur objektivin e mbetjeve komunale. Bullgaria, Kroacia, Qiproja, Greqia, Hungaria, Lituania, Malta, Polonia, Rumania dhe Sllovakia janë në rrezik të humbasin objektivat për mbetjet komunale dhe ato të përgjithshme të paketimit për vitin 2025. Disa vende gjithashtu vazhdojnë të depozitojnë pjesën më të madhe të mbetjeve të tyre komunale dhe ndoshta do të dështojnë për të përmbushur objektivin e vitit 2035 për depozitim të mbetjeve. Komisioni paraqet rekomandime për këto shtete anëtare, duke u bazuar në mbështetjen e vazhdueshme financiare dhe teknike të ofruar për përmirësimin e performancës në menaxhimin e mbetjeve.

Gjenerimi i mbetjeve në rritje

Çdo vit, evropianët gjenerojnë mesatarisht 530 kg mbetje komunale për person (mbeturinat që vijnë nga familjet dhe mbetje të ngjashme nga bizneset). Edhe pse riciklohen gjithnjë e më shumë dhe më pak deponohen, mbetjet bashkiake mbeten një nga rrymat më komplekse të mbetjeve për t'u menaxhuar. Në BE, rreth 50% e mbetjeve komunale riciklohen ose kompostohen dhe 23% depozitohen në landfill. Sasia e mbetjeve të paketimit të krijuara ka qenë në rritje të vazhdueshme. Midis 2013 dhe 2020 sasia e mbetjeve të paketimit të krijuara u rrit me 15% në të gjithë BE-në, duke arritur në afro 80 milionë tonë. Rreth 64% e mbetjeve të paketimit tani riciklohen, megjithëse kjo ndryshon sipas materialit. Më shumë se 75% e ambalazheve të letrës, kartonit dhe metalit riciklohen, krahasuar me më pak se 40% të plastikës - një problem në shumicën e vendeve të BE-së, shumë prej të cilave janë në rrezik të mos përmbushin objektivin specifik material për riciklimin e ambalazheve plastike.

Dallime të rëndësishme midis shteteve anëtare

Raporti tregon se ka dallime të rëndësishme në performancën e menaxhimit të mbetjeve në të gjithë BE-në. Për disa vende, ka ende një rrugë të gjatë për të bërë për të arritur objektivat e rënë dakord në legjislacionin e BE-së dhe nevojiten më shumë reforma, veçanërisht: për të siguruar trajtimin e mbetjeve biologjike, që përfaqëson një të tretën e mbetjeve komunale; grumbullimi i ndarë i mbetjeve - një parakusht për riciklimin; dhe të përmirësojë cilësinë e të dhënave. Megjithatë, shumica e vendeve të BE-së kanë ose janë në proces të vendosjes së reformave të mbetjeve për të përmirësuar normat e riciklimit, disa prej të cilave duhet të japin rezultate në vitet e ardhshme.

Faktorët e jashtëm ndikuan gjithashtu në performancë, duke përfshirë efektet e pandemisë COVID-19, e cila reduktoi ose ndaloi grumbullimin e veçantë në disa vende. Rritja e fundit e çmimeve të energjisë po ndikon negativisht gjithashtu në aktivitetet e riciklimit.

Rekomandimet dhe mbështetja e BE-së

Komisioni po paraqet rekomandime specifike për 18 shtetet anëtare që rrezikojnë të mos arrijnë objektivat kryesore të riciklimit për vitin 2025. Këto rekomandime mbulojnë një gamë të gjerë veprimesh: reduktimin e mbetjeve të pa riciklueshme, rritjen e ripërdorimit, nxitjen e grumbullimit të veçantë, zhvillimin e kapaciteteve



të trajtimit të mbetjeve për klasifikimin dhe riciklimin, përmirësimin e qeverisjes, vendosjen e instrumenteve ekonomike dhe rritjen e ndërgjegjësimit.

Komisioni do të vazhdojë të mbështesë Shtetet Anëtare për të zbatuar legjislacionin e BE-së për mbetjet, përmes mbështetjes së fondeve të BE-së, asistencës teknike (për shembull përmes

Rishikimit të Zbatimit Mjedisor, shkëmbimit të praktikave më të mira dhe promovimit të të mësuarit nga kolegët).

Megjithatë, autoritetet kombëtare janë përgjegjëse për intensifikimin e përpjekjeve të politikave dhe rritjen e veprimeve në terren. Për më tepër, Komisioni ka paraqitur iniciativë që

kontribuojnë në një ekonomi më rrethore dhe do të mbështesë Shtetet Anëtare në përmirësimin e performancës në menaxhimin e mbetjeve dhe arritjen e objektivave, siç janë propozimet për rregulloret e reja për dërgesat e mbetjeve, mbetjet e paketimit dhe paketimit dhe për projektimin ekologjik për të qëndrueshëm. produkteve.

Bashkimi Evropian i Shëndetit: Një qasje e re gjithëpërfshirëse për shëndetin mendor

Duke përmbushur angazhimin e Presidentes von der Leyen në fjalimin për gjendjen e Bashkimit Evropian 2022, Komisioni i shton një shtyllë Bashkimit Evropian të Shëndetit: një qasje të re gjithëpërfshirëse për shëndetin mendor.

Kjo qasje është një hap i parë dhe i rëndësishëm për të vendosur shëndetin mendor në të njëjtin nivel me shëndetin fizik dhe për të siguruar një qasje të re, ndërsektoriale ndaj çështjeve të shëndetit mendor. Me 20 nisma kryesore dhe 1.23 miliardë euro në financim të BE-së nga instrumente të ndryshme financiare, Komisioni do të mbështesë Shtetet Anëtare që të vënë njerëzit dhe shëndetin e tyre mendor në plan të parë.

Ky komunikim vjen në kohën e duhur: përpara pandemisë COVID-19, problemet e shëndetit mendor prekin tashmë 1 në 6 persona në BE, situatë e cila është përkeqësuar me krizat e paprecedentë të përjetuara gjatë viteve të fundit. Kostoja e mosveprimit është e konsiderueshme, duke arritur në 600 miliardë euro çdo vit.

Çështjet e shëndetit mendor dhe elementët kryesorë për të trajtuar çështjet e shëndetit mendor Në sfondin e ndryshimeve të rëndësishme teknologjike, mjedisore dhe shoqërore, që ndikojnë në aftësinë e njerëzve për t'u përballur, veprimi i BE-së për shëndetin mendor do të fokusohet në tre parime udhëzuese:

- Parandalimin adekuat dhe efektiv
- Akses në kujdesin dhe trajtimin e shëndetit mendor me cilësi të lartë dhe të përballueshme
- Riintegrimi në shoqëri pas rimëkëmbjes

Kjo qasje gjithëpërfshirëse shikon shëndetin mendor në të gjitha politikat për të njohur faktorët e rrezikut të shumëanshëm të shëndetit të sëmurë mendor. Duke ndjekur këtë qasje, veprimet konkrete do të mbulojnë një fushë të gjerë politikash dhe do të përfshijnë përpjekjet për:

- Promovimi i shëndetit të mirë mendor përmes parandalimit dhe zbulimit të hershëm, duke përfshirë një iniciativë evropiane për parandalimin e depresionit dhe vetëvrasjeve, një



Kodi Evropian për Shëndetin Mendor dhe kërkime të forcuara mbi shëndetin e trurit.

- Investim në trajnimin dhe ngritjen e kapaciteteve që përforcon shëndetin mendor përgjatë politikave dhe përmirëson aksesin në trajtim dhe kujdes. Veprimet do të përfshijnë programe trajnimi dhe shkëmbimi për profesionistët dhe mbështetje teknike për reformat e shëndetit mendor në nivel kombëtar.
- Sigurimi i shëndetit të mirë mendor në punë,

duke rritur ndërgjegjësimin dhe duke përmirësuar parandalimin. Kjo do të bëhet për shembull përmes fushatave të ndërgjegjësimin në mbarë BE-në nga Agjencia Evropiane për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë (EU-OSHA) dhe një nismë të mundshme të ardhshme të BE-së për rreziqet psiko-sociale në punë.

- Mbrojtja e fëmijëve dhe të rinjve gjatë viteve të tyre më të cënueshme dhe formuese, në një kontekst presionesh dhe sfidash në rritje. Masat përfshijnë një rrjet të shëndetit mendor të fëmijëve dhe të rinjve, një paketë mjetesh parandaluese për fëmijët që adreson përcaktuesit kryesorë të shëndetit të shëndetit mendor dhe fizik, dhe mbrojtje më të mirë në internet dhe në mediat sociale.

- Adresimi i grupeve vulnerabil, duke ofruar mbështetje të synuar për ata që kanë më shumë nevojë, siç janë të moshuarit, njerëzit në situata të vështira ekonomike ose sociale dhe popullsitë emigrantë/refugjatë. Një fokus i veçantë përfshin popullsitë e prekura nga konflikti, veçanërisht njerëzit (në veçanti fëmijët) të zhvendosur nga Ukraina dhe fëmijët në Ukrainë që janë subjekt i traumave të luftës.

- Udhëheqja me shembull, në nivel ndërkombëtar, duke rritur ndërgjegjësimin dhe duke ofruar mbështetje cilësore të shëndetit mendor në emergjencat humanitare.

Pesë sfida kryesore për ta bërë AI-në të sigurt

Ekspertët e inteligjencës artificiale përgjithësisht ndjekin një nga dy shkollat e mendimit - ose atë që do të përmirësojë jashtëzakonisht jetën tonë ose atë që do të na shkatërrojë të gjithëve. Dhe kjo është arsyeja pse debati i kësaj jave në Parlamentin Evropian mbi mënyrën se si rregullohet teknologjia është kaq i rëndësishëm. Por si mund të bëhet e sigurt AI? Këtu janë pesë nga sfidat përpara.

Rënia dakord se çfarë është inteligjenca artificiale

Parlamentit Evropian i janë dashur dy vjet për të nxjerrë një përkufizim të një sistemi AI - softuer që mund "për një grup të caktuar objektivash të përcaktuara nga njeriu, të gjenerojë rezultate të tilla si përmbajtje, parashikime, rekomandime ose vendime që ndikojnë në mjediset me të cilat ndërveprojnë".

Parlamenti Evropian po voton mbi Aktin e Inteligjencës Artificiale - rregullat e para ligjore të llojit të tyre për AI-në, të cilat shkojnë përtej kodeve vullnetare dhe kërkojnë që kompanitë ta respektojnë.

Arrija e marrëveshjes globale

Ish-kreu i Zyrës së Mbretërisë së Bashkuar për Inteligjencën Artificiale, Sana Kharaghani, thekson se teknologjia nuk ka respekt për kufijtë.

"Ne duhet të kemi bashkëpunim ndërkombëtar për këtë - e di se do të jetë e vështirë", u shpreh ajo për "BBC News". "Kjo nuk është një çështje e brendshme. Këto teknologji nuk qëndrojnë brenda kufijve të një vendi.

Por nuk ka plan për një rregullator global të AI-së të stilit të Kombeve të Bashkuara - megjithëse disa e kanë sugjeruar atë - dhe teritoritë ndryshme kanë ide të ndryshme:

Propozimet e Bashkimit Evropian janë më të rreptat dhe përfshijnë klasifikimin e produkteve të AI-së në varësi të ndikimit të tyre - një filtër i postës elektronike të spam-it, për shembull, do të kishte rregullim më të lehtë sesa një mjet për zbulimin e kancerit.

Mbretëria e Bashkuar po e fut rregulloren e AI-së në rregullatorët ekzistues - ata që thonë se teknologjia i ka diskriminuar, për shembull, do të shkojnë në Komisionin e Barazive.

Shtetet e Bashkuara kanë vetëm kode vullnetare, me ligjvënës të pranorj, në një seancë dëgjimore të fundit të komitetit të AI-së, shqetësimet nëse ata ishin të gatshëm për këtë detyrë.

Kina synon t'i detyrojë kompanitë të njoftojnë përdoruesit sa herë që përdoret një algoritëm i AI-së.

Sigurimi i besimit publik

"Nëse njerëzit i besojnë, atëherë ata do ta përdorin atë", - thotë kreu i qeverisë së BE-së dhe çështjeve rregullatore të Korporatës International Business Machines (IBM), Jean-Marc Leclerc.

Ka mundësi të mëdha për AI për të përmirësuar jetën e njerëzve në mënyra të jashtëzakonshme si:

- duke ndihmuar në zbulimin e antibiotikëve
- duke i bërë të paralizuarit të ecin përsëri
- duke adresuar çështje të tilla si ndryshimet klimatike dhe pandemitë

Por, ç'të themi për shqyrtimin e aplikantëve për punë ose parashikimin se sa gjasa ka që dikush të kryejë krim?

Parlamenti Evropian dëshiron që publiku të informohet për rreziqet që i bashkëngjitet çdo produkti të AI-së.

Kompanitë që thyejnë rregullat e saj mund të gjobiten me 30 milionë euro ose 6% të xhiros vjetore globale.

Por a mund të parashikojnë apo kontrollojnë zhvilluesit se si mund të përdoret produkti i tyre?

Vendosja se kush i shkruan rregullat

Deri më tani, AI ka qenë kryesisht i vetë-policuar.

Kompanitë e mëdha thonë se janë në për-



puthje me rregulloren e qeverisë - "kritike" për të zbutur rreziqet e mundshme, sipas Sam Altman, shef i "OpenAI" krijues i "ChatGPT".

Por a do t'i vënë ata fitimet para njerëzve nëse përfshihen shumë në shkrimin e rregullave?

Mund të vini bast se ata duan të jenë sa më afër ligjvënësve të ngarkuar me përcaktimin e rregulloreve.

Dhe themeluesja e "Lastminute.com", Baronessa Lane-Fox, thotë se është e rëndësishme të dëgjosh jo vetëm korporatat.

"Ne duhet të përfshijmë shoqërinë civile, akademikë, njerëzit që preken nga këto modele dhe transformime të ndryshme", - thotë ajo.

Duke vepruar shpejt

Microsoft, i cili ka investuar miliarda dollarë në ChatGPT, dëshiron që ai "të heqë nga puna mundimin".

Ai mund të gjenerojë prozë dhe përgjigje tekstuale të ngjashme me njeriun, por, thekson zoti Altman, është "një mjet, jo një krijesë".

Chatbot-et supozohet t'i bëjnë punëtorët më produktivë.

Dhe në disa industri, AI ka kapacitetin për të krijuar vende pune dhe për të qenë një asistent i mrekullueshëm. Por të tjerët i kanë humbur tashmë - muajin e kaluar, BT njoftoi se AI do të zëvendësonte 10 000 vende pune.

ChatGPT hyri në përdorim publik pak më shumë se gjashtë muaj më parë. Tani, ajo mund të shkruajë ese, të planifikojë pushimet e njerëzve dhe të kalojë provimet profesionale. Aftësia e këtyre modeleve gjuhësore në shkallë të gjerë po rritet me një ritëm fenomenal.

Dhe dy nga tre "kumbarët" e AI - Geoffrey Hinton dhe Prof Yoshua Bengio - kanë qenë ndër ata që kanë paralajmëruar se teknologjia ka një potencial të madh për dëm.

Akti i Inteligjencës Artificiale nuk do të hyjë në fuqi të paktën deri në vitin 2025 - "shumë vonë", thotë shefja e teknologjisë e BE-së, Margrethe Vestager.

Ajo po harton një kod të përkohshëm vullnetar për sektorin, së bashku me SHBA-në, i cili mund të jetë gati brenda javësh.

Dronët që mund të shmangin armiqët dhe të ofrojnë furnizime thelbësore

Marinsat amerikanë së shpejti do të kenë një mënyrë për të dërguar ushqim, ujë, municion dhe furnizime të tjera në njësitë me milje larg njëra-tjetrës, të gjitha këto pa vënë asnjë automjet në rrugë. Këta dronë të rinj të shpërndarjes ajrore, të quajtur Sistemet e Avionëve Pa pilot të Rifurnizimit Taktik (TRUAS), mund të ngrenë deri në 68 kg ngarkesë dhe ta fluturojnë atë deri në nëntë milje, duke shmangur forcat armike dhe madje duke i hedhur furnizimet nga ajri nëse është e nevojshme.

Dhe ky mund të jetë vetëm fillimi. Marinsat planifikojnë t'i rrisin këto përpjekje për të kryer përfundimisht furnizime më të rënda gati 200 milje.

Trupat e Marinës, sipas "Defence News", përfshijnë 41 prej dronëve në kërkesën e buxhetit të vitit 2024. Dronët kanë një kosto prej rreth 325 000 dollarë secili, me një kosto totale të programit (përfshirë automjetet e testimit të blera tashmë) prej rreth 13 milionë dollarë. Shumica, ka të ngjarë të drejtohen në tre regjimentet bregdetare detare, që po ngrihen njësi të dizajnuara për të luftuar nëpër zinxhirët e ishujve në Paqësor.

Droni TRUAS i paraqitur këtu duket si një brumull i madh me ngjyrë rëre dhe transportohet në një kuti plastike Hardigg, me katër rotorët të palosur nga brenda për të krijuar një profil më kompakt. Droni peshon 120 paund, përfshirë baterinë dhe mund të përgatitet për fluturim nga një ekuipazh tokësor prej dy personash në më pak se 10 minuta.

TRUAS kontrollohet nëpërmjet një tableti që ngarkon të dhënat e navigimit në dron. Operatori mund të ngrejë një geofence për ta mbajtur dronin brenda ose jashtë një zone të caktuar dhe të vendosë pika rrugësh që droni të fluturojë gjatë rrugës për në destinacionin e tij. (Operatori gjithashtu mund ta programojë dronin që të fluturojë në një lartësi të caktuar.) Së fundi, droni mund të ulet dhe të lëshojë ngarkesën e tij ose ta lëshojë atë nga ajri, me lartësinë e rënies të vendosur nga operatori.

Kuadrokteri TRUAS i përshatet një roli që marinsat e quajnë Small Pa Manned Logistics System Air, ose Small ULS-A. Marinsat e përshkruajnë atë si një mënyrë për të mbajtur



ekipet dhe togat plotësisht të furnizuara në terren. Për sa i përket numrave, një dron do të plotësonte nevojat e 100 deri në 200 trupave në një fushë beteje relativisht të vogël.

Natyrisht, ka të ngjarë të mos ndalet me kaq nëse duket e dobishme. Korpusi po shikon gjithashtu versione më të mëdha të dronëve, Medium ULS-A, drone që mund të mbajnë 136 deri në 262 kg me një rreze prej 25 deri në 100 milje detare. Kjo nga ana tjetër do të pasohet nga ngritësi vertikal transformues edhe më i madh i përdorimit të dritës (TVL) me një ngarkesë prej 450 deri në 1360 kg dhe një rreze prej të paktën 186 miljesh. (Distanca ka të ngjarë të përcaktohet nga Regjimi i Kontrollit të Teknologjisë së Raketave, një marrëveshje ndërkombëtare që kufizon rrezen maksimale për raketat me ngarkesë deri në 498 kg, që mund të jetë një dron, në 186 milje.) Droni i parë TRUAS do të jetë i dobishëm për njësitë e vogla, por përparimi i vërtetë do të jetë në vënien në terren të dronëve më të mëdhenj. Gama do të lejojë dronët të kërcejnë nga një zonë në tjetrën, e cila nga ana tjetër do t'i lejojë marinsat të përhapen, duke mbuluar më shumë tokë ndërsa shpërndahen për të shmangur sulmet nga armët me distanca të gjata dhe të drejtuara me saktësi.



Eqerem Gaxholli, skënderbegasi i shquar në diplomaci

Skënderbegasi Eqerem Gaxholli lindi më 10 shkurt 1945 në fshatin Kërpicë, rrethi Gramsh, në një familje patriotike, atdhetare e arsimdashëse. Gjyshi i tij nga nëna ka qenë nxënës në Gjimnazin Kombëtar të Korçës. Nga viti 1952-1956 kreu shkollën fillore “Vesël Hova” në fshatin e lindjes. Arsimin 7-vjeçar e kreu në shkollën “Shefqet Guzi”, Gramsh (1956-1959) me bursë shtetërore. Më pas vijon studimet në Shkollën e Mesme të Përgjithshme Ushtarake “Skënderbej” (1959-1963), në Tiranë. Në shkollën fillore mësoi ABC-në, ndërsa në shkollën e Mesme të Përgjithshme Ushtarake “Skënderbej” ai mori çelësin që i hapi rrugën drejt një të ardhme të suksesshme.

Në këtë shkollë fitoi një kulturë të përgjithshme dhe solide bazë për studimet universitare brenda dhe jashtë vendit. Dhe këtë ia dedikon kësaj shkolle, mësuesve të tij-prindër, ku midis të cilëve ai citon drejtorin e shkollës Stavri Angjeli, mësuesin kujdestar, të rreptë, kërkues por zemërgjerë Viron Cinxo, mësuesit Viron Tane, Sadete Kasa, Drita Hajro, Marie Nano, Kozma Vasili, Lluca Nikollari, Ismet Bellova, Bejkush Birçe etj. Kujton me respekt të thellë edhe kujdesin atëror të oficerëve, të cilët marrëdhëniet me nxënësit skënderbegas i kishin ndërtuar si marrëdhënie prindër-fëmijë. Midis tyre përmenden me mirënjohje të thellë Malo Malaj, Aristidh Ngjela, Rexh Ndreu, Muhamet Ormeni, Refik Kucaj, Muhamet Hoxha etj. Ndihet krenar dhe e konsideron privilegj që ka qenë pjesë e maturës së vitit 1963, nga ku kanë dalë kuadro të devotshëm që i shërbyen atdheut në funksionet më të larta në forcat e armatosura dhe në fusha të tjera shoqërore e kulturore të artit, diplomacisë etj. Midis tyre përmenden Gjeneral Kostaq Karoli, ish-shëf i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë, Fitim Halili, admiral, komandant i Flotës Luftarako-Detare, Profesor Myslym Pashaj (Kolonel i Detit), Novruz Sako, komisar i Shkollës së Bashkuar të Oficerëve “Enver Hoxha”, sot Akademia Ushtarake “Skënderbej”, piloti Dëshmor Luto Sadiku, sportisti Patriot Aliaj, Roland Paluka, Kuadër i Shërbimit të Radiozbulimit, Zoi Toska, diplomat, Bardhyl Mezin, profesor filozofie në Fakultetin e Shkencave Politiko-Juridike në Universitetin e Tiranës, Thoma Konduri, ndihmës i zëvendëshefit të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë për Artilerinë, Mëhill Pepa, publicist, Novruz Yzeiri, kantautor dhe Eduard Isufi profesor në Universitetin Shtetëror të Tiranës etj. Eqeremi, në periudhën shtator 1963 - korrik 1965 kreu studimet në Shkollën e Bashkuar të Oficerëve “Enver Hoxha” (sot Akademia Ushtarake “Skënderbej”), dega Gjitharmësh. Pas përfundimit të studimeve me rezultate të shkëlqyera nga ky institucion prestigjioz iu dha grada Toger. Më pas vijon studimet e rregullta në Kolegjin dyvjeçar për Marrëdhënie Ndërkombëtare (Diplomaci Ushtarake) dhe gjuhë të huaja që hapej në funksion të nevojave të Drejtorisë së Zbulimit në Ministrinë e Mbrojtjes, ku u specializua për Zbulimin Ushtarak të Jashtëm si edhe mësimin e gjuhës franceze. Trupa mësimore përbëhej nga kuadro me nivel të lartë profesional e kulturor, njohës të gjuhëve të huaja që shërbenin në Drejtorinë e Zbulimit Ushtarak, Diplomati në Ministrinë e Punëve të Jashtme, Pedagogë të Fakultetit të Drejtësisë, Histori-Filologjisë dhe të Gjuhëve të Huaja të Universitetit të Tiranës. Pas përfundimit me rezultate të mira të Kolegjit, shërbeu i komanduar për disa muaj pranë detashmentit të zbulimit të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë. Mandej për një periudhë dyvjeçare punoi si oficer në Shërbimin e Radiozbulimit, si përkthyes dhe përpunues informacioni që kishin të bënin me zhvillimet në fushën ushtarake dhe politike të vendeve fqinje, në Ballkan e më gjerë.

Përkthimi i librit “David dhe Goliath”, ku analizohej konflikti izraelo-arab, si dhe i dy librave të tjerë mbi përdorimin e raketave kundërajrore gjatë operacioneve luftarake në këtë konflikt shënoi një kthesë në karrierën e tij. Librat e materialet u vlerësuan nga ministri i Mbrojtjes në atë periudhë Beqir Balluku dhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë, Petrit Dume. Me porosi të tyre dhe mbështetjen e Drejtorit të Drejtorisë së Zbulimit të Ushtrisë Andon Sheti, ai filloi studimet e larta në Universitetin Shtetëror të Tiranës, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Dega Gjuhë-Letërsi Franceze, ku jepnin mësim një trup pedagogjik me nivel kulturor e profesional të jashtëzakonshëm dhe që përbëhej nga dy pedagogë francezë dhe profesorët e njohur Vedat Kokona, Nonda Bulka, Vasil Bombaj, etj. Pas një viti studimesh ai fitoi konkursin për të vijuar studimet e larta në Francë, Paris, në Institutin e Profesorëve të Frëngjishtes për



të Huajt - Sorbonë e Re, me bursë të Qeverisë Franceze dhe lejen e autoriteteve shqiptare, në bazë të marrëveshjes kulturore dypalëshe franko-shqiptare. Studimet i përfundoi me rezultate të mira dhe iu akordua diploma “Profesor i Gjuhës Franceze për të Huajt”. Gjithashtu ai ka kryer edhe studimet pa shkëputje nga puna në Fakultetin e Drejtësisë në Universitetin Shtetëror të Tiranës, ku është diplomuar “Jurist”. Pas kthimit në atdhe, emërohet në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Republikës së Shqipërisë, duke mbajtur funksione të larta në Shërbimin e Jashtëm Diplomatik në disa vende: Hungari-Budapest, Diplomati në Francë-Paris i akredituar në Bruksel-Holandë dhe në UNESCO “Organizata e Kombeve të Bashkuara për Arsimin, Shkencën dhe Kulturën”; Diplomati (pallati i Qelqit) në OKB (1988-1992) i akredituar edhe në Kanada.

Në OKB ka qenë përfaqësues i Shqipërisë në Komisionin e Pestë të Politikave Speciale, i cili ndiqte kryesisht çështjet politike e diplomatike të Lindjes së Mesme.

Në ushtrimin e veprimtarisë së tij diplomatike, si diplomat ai ka shërbyer me korrektësi, përkushtim e profesionalizëm për mbrojtjen e interesave të shtetit dhe kombit shqiptar në përputhje të plotë me politikën e jashtme të Shqipërisë të asaj kohe, të sanksionuara në ligjin themeltar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Ka

punuar në zgjerimin dhe forcimin e marrëdhënieve dypalëshe e shumëpalëshe të Shqipërisë me vendet e tjera në të gjitha fushat me interes reciprok si dhe në rritjen e rolit të Shqipërisë në rajonin e Ballkanit e më gjerë për ruajtjen e paqes dhe të stabilitetit.

Gjatë qëndrimit në Shqipëri ai ka qenë pedagog i jashtëm i gjuhës franceze në Universitetin Shtetëror të Tiranës. Zotëron shumë mirë gjuhën francezë si edhe ka njohuri e aftësi komunikimi në gjuhët rusisht, hungarisht, anglisht e spanjisht. Në disa raste ka qenë përkthyes zyrtar i Kryeministrit Mehmet Shehu, Presidentit Haxhi Lleshi, Ministrave të Jashtëm Nesti Nase e Reis Malile, shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë, Veli Llakaj etj.

Për punë e kontribute të shquara është dekoruar me urdhra e medalje nga Kuvendi Popullor i Shqipërisë.

Pas ndryshimeve politike e shkëputjes nga shërbimi diplomatik ai punoi si përkthyes dhe konsulent juridik në disa organizata ndërkombëtare të Komunitetit Europian në vendin tonë.

Më pas, për një periudhë prej rreth 15 vitesh pasi fitoi Licencën e Noterit, ushtroi profesionin e Noterit mbi bazën e një konkursi të organizuar nga Ministria e Drejtësisë. Krahas ushtrimit të këtij profesioni ai ka dhënë edhe kontribut në pasurimin e ligjit shqiptar “Mbi Noterinë në Republikën e Shqipërisë”, duke bërë përkthime për llogari të Institucionit të Noterisë të mjaft materialeve mbi teorinë dhe praktikën e Kodit Civil francez dhe të legjislacionit noterial latin. Është nderuar me Certifikatën e Mirënjohjes dhe Presidentja e Dhomës Kombëtare të Noterisë, zonjës Mimoza Sadushi me motivacion “Për kontributin e dhënë gjatë ushtrimit të detyrës si noter, deri në plotësimin e moshës së lejuar për ushtrimin e profesionit”.

Ai ka përgatitur dhe legjitimuar si Noter të gjithë dokumentacionin ligjor të Shoqatës Kombëtare “Skënderbegasi”, ka dhënë kontribut në botimin e gazetës periodike “Skënderbegasi”, si edhe në organizimin e disa aktiviteteve vjetore të saj. Si anëtar i kësaj shoqate dhe për kontributin e dhënë është nderuar me Certifikatë Mirënjohjeje nga Shoqata Kombëtare “Skënderbegasi” me motivacionin: “Për rezultate të larta në shkollë. Me punën e Tij ka ngritur lart emrin e skënderbegasit, të shkollës dhe të ushtrisë. Kudo ku

ka shërbyer, ka mbrojtur me dinjitet interesat e atdheut”.

Në datën 10 shkurt 2015, Aleanca Kombëtare e Ushtarakëve të Shqipërisë i akordon Certifikatë Mirënjohjeje me rastin e 70-vjetorin e lindjes me motivacion: “Për kontributin e shquar në realizimin e detyrave të shoqatës, për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të ushtarakëve shqiptarë; për pranimin e aleancës kombëtare të ushtarakëve të Shqipërisë në Institucionet Ndërkombëtare si dhe për kontributin gjatë karrierës së Tij në diplomacinë shqiptare”.

Është vlerësuar me Çmimin “Babel”, si përkthyesi shqiptar më i mirë për vitin 2021, akorduar nga revista amerikane për letërsi dhe arte “Mundus Artium” pranë Universitetit të Teksasit në SHBA.

Pas daljes në pension vazhdon të punojë në fushën e përkthimeve, duke sjellë në shqip disa libra kryesisht me përmbajtje historiko-letrare, e konkretisht: Planet e Hitlerit për Ballkanin, me autor Johachim Von Ribentrop (ish-Ministër i Punëve të Jashtme të Hitlerit); Gjeneral de Gol - Historia e Jashtëzakonshme e Liderit të Francës Moderne; Viktor Hygo - Jeta dhe Vepra e Gjeniut të Francës; Robespier dhe Revolucioni Francez.

Ka në proces për botim “Napoleon Bonaparti ‘Zot i Luftës’”.



Prof. Asoc. Dr. Bernard Zotaj

Kryengritja e vitit 1924 kishte një përmbajtje demokratike dhe ishte vijim i revolucionit kombëtar të vitit 1920, por me një ndryshim thelbësor: nëse më 1920-tën populli shqiptar luftoi kundër pushtuesve të huaj për rifitimin e pavarësisë kombëtare, më 1924 forcat demokratike u ngritën kundër feudalëve dhe borgjezisë për t'i larguar nga jeta politike, ekonomike dhe shoqërore e vendit e për demokratizimin e tij. Kryengritjen e qershorit të vitit 1924 u organizua dhe u drejtua nga forcat demokratike, që synonin në përdorimin e pushtetit politik për zgjidhjen e problemeve ekonomike e shoqërore të vendit. Çështja kryesore ishte zgjidhja e çështjes agrare, për të cilën ishte e interesuar fshatarësia, forca kryesore e kryengritjes. Fshatarësia shqiptare paraqitej e larmishme. Një pjesë e saj ëndërronte të bëhej pronare e një copë toke ose ta zgjeronte sasinë e pakët të tokës që zotëronte. Pjesa tjetër donte të çlirohej nga detyrimet e rënda e të shumta shtetërore, si nga e dhjeta, nga taksa e xhelepit, nga ajo e vergjisë dhe nga mbeturinat e tjera të sistemit feudal. Qëndresa e fshatarësisë kundër detyrimeve shtetërore ishte më e fuqishme se qëndresa përballë pronarëve të tokave. Marrja pjesë e ushtrisë në këtë kryengritje nuk i heq kësaj përmbajtjen antif feudale dhe nuk i vesh vellon e “puçit ushtarak”, sikurse e quanin qëllimisht disa forca antidemokratike.

Jo, zotërinj të ndershëm, qe një revolucion, dhe si të gjithë revolucionet, përmbysi të tëra idetë e regjimit të përparshëm dhe duhet të përmbyste të gjitha veglat e atij regjimi, shkruante gazeta “Bashkimi” pas fitores së kryengritjes. Historiografia e sotme herë pas here bën përpjekje për të mohuar karakterin demokratik të revolucionit, për ta paraqitur kryengritjen e qershorit si një “puç ushtarak”. Opinione të tilla janë subjektive dhe bien ndesh me zhvillimin e ngjarjeve politike të asaj periudhe, nuk marrin parasysh problemet politike, ekonomike e sociale që duhej të zgjidhte shoqëria shqiptare dhe aspiratat e popullit shqiptar në atë kohë. Në polemikë me ata që kritikonin organizimin e shpërthimit e kryengritjes së armatosur dhe që vinin në dyshim domosdoshmërinë objektive të saj, Fan Noli shkruante se që pas vrasjes së Avni Rustemit, nuk kish njeri që ta ndalonte kryengritjen, se ashtu sikundër është zor të fabrikohet një kryengritje pas qejfit, ashtu është edhe zor të ndalohet kryengritja e provokuar kur ndizen gjakrat.

Organizimi i forcave dhe plani i sulmit

Frontin e Jugut e përfaqësonin forcat ushtarake të garnizonit të Përmetit dhe vullnetarët e Skraparit të drejtuar nga Riza Cerova. Nga fundi i muajit maj të 1924-ës patrioti Riza Cerova i bëri thirrje popullit të Skraparit të ngrihej në këmbë për të luftuar dhe për të shkuar në Tiranë që të rrëzonte klikën e Zogut. Thirrjes së tij iu përgjigjën mjaft fshatarë. Forcat vullnetare të Skraparit, nën drejtimin e Riza Cerovës u mbledhën në Ujë të Zi, të Skraparit. Aty u mbledhën mbi 100 luftëtarë. Me organizimin luftarak që bëri komandant Rizai, kaluan në Teman, Xhitem dhe u përqendruan në Drobonik, në juglindje të Beratit. Gjatë rrugës u bashkuan dhe shumë vullnetarë skraparlinj dhe të Nahisë së Beratit. Këtu pritën çetën e Dishnicës nga Përmeti të drejtuar nga trimat Ahmet e Abaz Kajca, si dhe çetën e drejtuar nga Ali Koprencka. Rizai kishte dërguar njoftim dhe ishin marrë vesh për të marshuar drejtë Tiranës. Këtu u formua dhe shtabi ushtarak për drejtimin e këtyre çetave të udhëhequr nga Riza Cerova. Në Drobonik u bë plani i sulmit kundër forcave zogiste që ndodheshin në Berat. Forcat kryengritëse të vendosura për të marshuar drejt Tiranës iu bënë thirrje Veiz Xhindit dhe Selaudin Blloshmit që të tërhiqeshin dhe të hapnin rrugën dhe të mos shkaktonin vëllavrasje. Por Veizi dhe Selaudini kundërshtuan.

Pasi hartuan planin e sulmit u nisëm. Çeta e Skraparit sulmoi nga ana lindore e qytetit të Beratit. Që në sulmin e parë luftëtarët marshuam deri te xhamia e Plumbit. Këtu u ndeshën me forcat qeveritare dhe u detyruam të tërhiqeshim deri afër Uznovës. Këtu zunë pozicione të reja luftimi dhe qëndruan deri në mbrëmje. Këtu erdhën dhe u bashkuan edhe disa luftëtarë të Beratit. Me rënien e mbrëmjes u organizua dhe u zhvillua sulmi i dytë me objektiva të

Revolucioni i Qershorit të 1924-ës



qarta për në qytet. Në këtë sulm forcat u ndanë në dy grupe dhe një pjesë qëndroi në rezervë. Grupi i parë sulmoi përsëri në drejtim të xhamisë së Plumbit dhe objektiv të afërt kishin marrjen e Kalasë, kurse grupi i dytë lëvizti nga kisha e Kondasit dhe sulmoi Kalanë, ku ishin përqendruar forcat e qeverisë së Zogut, të cilat komandoeshin nga Veiz Sevrani. Çeta e drejtuar nga Abas Kajca, që ishte dhe drejtuesi i artilerisë, goditi kodrat me ulla, ku ishin vendosur forcat e qeverisë të komanduara nga Selaudin Blloshmit. Kur ra mbrëmja plotësisht sulmuan forcat vullnetare që komandoeshin nga Riza Cerova. Këto kapërcyen lumin dhe iu drejtuan Bregut, te Kisha e Kondasit. Terreni ishte i sheshtë dhe i hapur, dhe sulmuesit ishin të ekspozuar. Rezistenca e Selaudit ishte e fortë. Komandant Rizai dërgoi Xhemal Malindin me 20 luftëtarë që duke kaluar grykën e Duhuanasit, doli tek Lisi i Beçit, dhe u mori krahët forcave qeveritare. Luftimet vazhduan dhe nga mezi i natës, u dëgjuan krismat e luftëtarëve të sulmit të Xhemalit që i sulmoi nga mali i Goricës. Selaudin Blloshmi, kishte zënë kodrat me ulla, në veri të qytetit, nga Kisha e Shëndëllisë, përkundrejt kalasë, gjer te kisha e Kondasit afër Drobonikut, duke parë se po i merreshin krahët, u tërhoq. Në kala ishin përqendruar forcat e xhandarmërisë që komandonte Veiz Xhindi, por u tërhoq nga fortesa e Kalasë. Të dy qeveritarët natën, u larguan nga pozicionet dhe dolën në anën e majtë të lumit Devollit, në Kozare, ku aty ishte përqendruar dhe Osman Gazepi, i ardhur nga Tirana me një batalion me ushtarë. Forcat e Dishnicës e nisën sulmin nga ana e Murat Çelepasis. Të ndodhura nën një zjarr të fortë, të vazhdueshëm dhe të rrethuara nga të gjitha anët, forcat zogiste u thyen dhe u tërhoqën në drejtim të Kuçovës. Nga mesi i natës krismat e pushkëve pushuan. Në mëngjes në qytet mbërriti pararoja e forcave kryengritëse, dhe me pas vullnetarët u pritën me brohoritje në qytet, ku mjaft të rinj u bashkuan me forcat kryengritëse. Në bashkinë e qytetit të Beratit ishte ngritur një komision me njerëz demokrat që ishte gati për të ndihmuar forcat kryengritëse me bukë, ushqime etj. Ky komision dërgoi një delegacion në Drobonik për të njoftuar gatishmërinë e tij në ndihmë të kryengritësve. Në Berat forcave kryengritëse iu

bashkuan dhe forca të reja vullnetare nga qyteti i Beratit dhe nga fshatrat përreth. Rrobaqepësit e Beratit, duke punuar natë e ditë, qepën gati 200-300 rroba doku, uniforma ushtarake, për të veshur vullnetarët civilë, të cilët u pajisën dhe me këpucë. U bë përsëri riorganizim i forcave dhe nisëm marshimin drejt Tiranës, duke ecur në rrugën e Perondisë dhe të Kozarës.

Luftimet në Kozare dhe marshimi për në Tiranë

Me çlirimin e Beratit, forcat kryengritëse marshuan në drejtim të Kozarës. Në Kozare ndeshëm në qëndresën e forcave qeveritare, të cilat ishin shtuar, sepse u kishin ardhur në ndihmë forca të reja, të komanduara nga Selaudin Blloshmi. Ndërsa nga Lushnja ishin nisur forca të tjera ushtarake, të komanduara nga Osman Gazepi. Me të ndeshur në rezistencën e tyre, ne zumë vend në kodrat e fshatit Kozare. Vau i lumit Devoll ishte zënë nga forcat e qeverisë. Rizai me ndihmën e vullnetarëve nga fshati Kozare, gjeti një va në Vlashuk. Lumi Devoll kishte shumë ujë, por forcat kryengritëse të lidhur dorë për dorë dhe të mbajtur pas një litari të gjatë kaluan Devollin. Riza Cerova nisi një çetë me luftëtarë në drejtim të Çiflikut, për t’u marrë krahët forcave qeveritare dhe për të penguar tërheqjen e tyre. Kryengritësit sulmuan të gjithë mercenarët që ishin grumbulluar në Kozare. Këtu u zhvilluan luftime të ashpra që përfunduan me shpartallimin e plotë të forcave qeveritare. Veizi dhe Selaudini u larguan së bashku me Osmanin. Midis mercenarëve të kapur ishte dhe babai i Selaudin Blloshmit. Krerët e mercenarëve u mbajtën, ndërsa ushtarët e thjeshtë, pasi u çarmatosën, u liruan. Shumica e ushtarëve të Osman Gazepit u bashkuan me forcat kryengritëse. Me fitoren në Kozare, forcat kryengritëse vazhduan marshimin në drejtim të Lushnjës, ku u përqendruan në kodrat e fshatit Karbunarë, pranë Lushnjës. Këtu forcat kryengritëse të Riza Cerovës u sulmuan përsëri nga trupat qeveritare, të cilat kishin rrethuar vendin e përqendrimit. Në këtë kohë erdhën në ndihmë forcat kryengritëse të Vlorës. Me bashkimin e të gjitha forcave të Jugut, u hodhën në sulm vendimtar dhe bënë shpartallimin e trupave zogiste. Forcat e Jugut marshuan për në Tiranë, duke mos gjetur asnjë pengesë. Kryengritësit kishin fituar.

QPRQPRQPRQPRQPR

**Qendra e Personel Rekrutimit, do të rekrutojë kandidatë për të ndjekur studimet për Përgatitjen e Oficerit të Ri në Akademinë e Forcave të Armatosura, për vitin akademik 2023 - 2024.
Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit është deri, më 25 gusht 2023.**



Për më shumë informacion klikoni më poshtë:

<https://www.mod.gov.al/newsroom-2/njoftime/6026-qendra-e-personel-rekrutimit-do-te-rekrutoje-kandidate-per-te-ndjekur-studimet-per-pergatitjen-e-oficerit-te-ri-ne-afa-per-vitin-akademik-2023-2024>